



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Kulturë, Media dhe Editim”**

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë**


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.dr. Çlirim Duro
2. Prof.asoc.dr. Ramadan Çipuri

Maj / 2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit “Master i Shkencave” në “Kulturë, Media dhe Editim” ofruar
nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli” Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Kulturë, Media dhe Editim
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i MASR Nr.387, Datë 10.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 78, datë 15.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (dy) vite akademike (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7 (Shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14 PAE/ 9 PAK v.a. 2022-2023 14 PAE/ 9 PAK v.a. 2023-2024
18	Numri i studentëve:	10 Studentë v.a. 2022-2023 11 Studentë v.a. 2023-2024
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” ofrohet nga Universiteti “Fan S. Noli” në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë. Programi është hapur me Urdhrin e MASR nr. 387, datë 10.07.2018, dhe është i nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ai zhvillohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, për një periudhë dyvjeçare (4 semestra) dhe realizohet me 120 kredi ECTS. Financimi i programit mbështetet nga të ardhurat e vetë universitetit.

Ky program synon të përgatisë specialistë të fushës së kulturës, medias dhe editimit përmes një qasjeje ndërdisiplinore që kombinon teorinë me praktikën. Kurrikula përfshin lëndë të formimit të përgjithshëm, karakterizues dhe plotësues, duke ofruar njohuri dhe aftësi të avancuara për të analizuar, menaxhuar dhe prodhuar përmbajtje në media tradicionale dhe digjitale, përkthim, redaktim dhe projekte kulturore. Programi synon të zhvillojë kompetenca të larta kërkimore dhe kritike, duke i aftësuar studentët për të operuar në sektorin kulturor dhe mediatik.

Përmes praktikave të integruara me institucione të ndryshme, studentët fitojnë përvojë konkrete pune dhe aplikojnë njohuritë e marra gjatë studimeve.

Të diplomuarit e këtij programi mund të angazhohen në pozicione si gazetarë, redaktorë, përkthyes, kuratorë të projekteve kulturore, analistë të medias dhe kërkues shkencorë. Gjithashtu, ata kanë mundësi të vijojnë studimet në nivel doktorature, duke u specializuar më tej në studimet kulturore, komunikimin dhe median.

Aktualisht, programi po i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar përmbushjen e standardeve akademike dhe përputhshmërinë me kërkesat bashkëkohore të tregut të punës.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë u zhvillua në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Institucioni dorëzoi Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), i cili përmbante analizën e detajuar të programit, evidencat mbështetëse dhe përmbushjen e kriterëve të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të plotë, ekspertët e jashtëm vijuan me fazën e vlerësimit në mjediset e institucionit.

Vizita e ekspertëve të jashtëm në universitet u zhvillua për dy ditë, midis datave 5-6 mars, 2025, duke ndjekur një agjendë të detajuar takimesh me aktorët kryesorë të përfshirë në program. Ekipi i vlerësimit përbëhej nga dy ekspertë të jashtëm, Prof.dr. Çlirim Duro dhe Prof.asoc.dr. Ramadan Çipuri, të shoqëruar nga Koordinatorja e ASCAL, znj. Aviola Bardhi. Ata realizuan takime me drejtuesit e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, përfaqësuesit e Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë, anëtarët e grupit të vlerësimit të brendshëm, si dhe personelin akademik të angazhuar në program. Gjithashtu, u zhvilluan diskutime me studentë të programit dhe përfaqësues të zyrave mbështetëse, përfshirë Zyrën e Këshillimit të Karrierës, Sekretarinë Mësimore dhe njësitë e tjera administrative, që ofrojnë mbështetje për studentët dhe procesin akademik.

Gjatë vizitës, drejtuesit e institucionit garantuan të gjitha kushtet e nevojshme për realizimin e takimeve dhe siguruan qasje të plotë në dokumentacionin mbështetës dhe ambientet universitare. Ekspertët e jashtëm patën mundësinë të vlerësojnë kapacitetet infrastrukturore, duke përfshirë auditoret, laboratorët, bibliotekën dhe hapësirat e tjera të lidhura me programin e studimit.

Në përfundim të vizitës, ekspertët e jashtëm analizuan të gjitha të dhënat e mbledhura dhe përgatitën Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, duke paraqitur gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet e tyre në përputhje me standardet e cilësisë në arsimin e lartë.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” ofrohet në përputhje me misionin dhe vizionin e Universitetit “Fan S. Noli”, duke synuar ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Programi është ndërtuar në bazë të kornizave ligjore dhe strategjike të institucionit, duke reflektuar objektivat e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, e cila thekson rëndësinë e edukimit mbi qytetarinë dhe ruajtjen e trashëgimisë kombëtare në një kontekst bashkëkohor. Përmes përmbajtjes ndërdisiplinore dhe qasjes së tij akademike, programi mbështet zhvillimin profesional të studentëve në fushën e kulturës, medias dhe editimit, duke garantuar përputhshmërinë me nevojat kombëtare dhe me standardet e arsimit të lartë. Statuti i Universitetit “Fan S. Noli” përcakton qartë angazhimin e institucionit në ruajtjen e identitetit kulturor dhe promovimin e vlerave akademike kombëtare.¹ Programi harmonizon traditat kulturore me zhvillimet moderne të medias dhe editimit, duke u mbështetur në parimet e diversitetit kulturor dhe inovacionit akademik. Struktura e programit siguron një kombinim të balancuar mes njohurive teorike dhe aftësive praktike, duke e bërë atë një model të qartë të qasjes së universitetit ndaj ruajtjes dhe zhvillimit të vlerave kombëtare në arsimin e lartë. Bazuar në dokumentacionin institucional dhe në rregulloret përkatëse të organizimit të veprimtarisë akademike^{2,3}, programi është i ndërtuar në përputhje me objektivat e institucionit për të formuar profesionistë të aftë për të kontribuar në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe akademike të vendit. Për

¹ Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë

² Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FEF

³ Shtojca 2.3 Rregullore e Njesise Baze (DGJL)

	më tepër, përmbajtja e programit dhe metodologjia e tij e zhvillimit janë të strukturuar për të siguruar përputhshmërinë me interesat kombëtare dhe me kërkesat e tregut të punës. Kjo tregon një qasje të qartë të universitetit në mbështetjen e objektivave strategjike për zhvillimin e arsimit të lartë në Shqipëri.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” është hartuar dhe ofruar në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike të Universitetit “Fan S. Noli”, duke integruar mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe angazhimin akademik në fushën e kulturës dhe medias. Statuti i institucionit përcakton se një nga qëllimet kryesore të tij është përgatitja e specialistëve që kontribuojnë në zhvillimin shoqëror dhe kulturor të vendit⁴, çka reflektohet në strukturën dhe përmbajtjen e programit. Programi zhvillohet në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit 2022-2027 të UNIKO⁵ dhe Rregulloren e Programit të Studimit⁶, duke garantuar balancën mes formimit teorik dhe praktik. Ai siguron përgatitjen e studentëve me kompetenca të avancuara për tregun e punës, në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe standardet kombëtare të arsimit të lartë. Me këtë strukturë, programi përmbush në mënyrë të qartë kriterin e përafrimit me fushën e veprimtarisë së institucionit.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregulloreve të Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli” (UNIKO),⁷ Statutin dhe Rregulloren e institucionit, duke reflektuar orientimet strategjike të universitetit dhe nevojat e tregut të punës. Në përputhje me Nenin 2 të Statutit të Universitetit,⁸ programi mbështet përgatitjen e profesionistëve në fushat e kulturës, medias dhe editimit, duke synuar zhvillimin e kompetencave të specializuara për sfidat bashkëkohore në këto fusha. Struktura e programit është ndërtuar duke respektuar standardet akademike dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, duke integruar komponentë teorikë dhe praktikë për të përgatitur studentët për rolet profesionale në sektorin kulturor dhe mediatik. Neni 6 i Statutit të Universitetit⁹ përcakton se programet e studimit

⁴ Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, neni 3

⁵ Shtojca 1.3 Plan i strategjik i zhvillimit të UNIKO

⁶ Shtojca 2.5. Rregullorja e programit të studimit: Master i shkencave në “Kulturë, media dhe editim”

⁷ Shtojca 1.3. Plan i strategjik i zhvillimit të UNIKO

⁸ Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë

⁹ Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë

	duhet të jenë në përputhje me zhvillimet akademike dhe nevojat e tregut të punës, duke siguruar një ekuilibër midis formimit akademik dhe praktikave të avancuara në fushat përkatëse. Për më tepër, Rregullorja e Programit të Studimit¹⁰ përcakton qartë qëllimet dhe metodologjinë e zbatimit të programit, duke garantuar një qasje fleksible dhe të përshtatshme me zhvillimet teknologjike dhe kërkesat e tregut të punës. Programi është konceptuar si një përgjigje ndaj këtyre sfidave dhe zhvillohet në përputhje me Rregulloren e Fakultetit,¹¹ duke siguruar që ai të jetë në harmoni me drejtimet akademike të institucionit. Rrjedhimisht, vlerësojmë se programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” përputhet me misionin dhe vizionin e institucionit, me objektivat strategjike të zhvillimit dhe me kërkesat bashkëkohore të sektorit kulturor dhe mediatik.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Referuar dokumentacionit të vë në dispozicion nga Institucioni, vlerësojmë se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” është hartuar dhe zhvilluar në përputhje me strategjitë kombëtare dhe prirjet globale, duke u mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe ndërkombëtar. Në nivel kombëtar, programi respekton objektivat e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030, duke synuar zhvillimin e kompetencave të studentëve në fushën e kulturës dhe medias dhe përshtatjen me nevojat e tregut të punës.¹² Në përputhje me prirjet globale, programi reflekton zhvillimet teknologjike dhe dixhitalizimin në media dhe botime, duke siguruar një balancë ndërmjet përmbajtjes akademike dhe aftësive praktike që lehtësojnë mobilitetin akademik dhe profesional të studentëve.¹³ Në përfundim, programi është ndërtuar në përputhje me dokumentet strategjike vendase dhe ndërkombëtare, duke kombinuar aspektet

¹⁰ Shtojca 2.5. Rregullorja e programit të studimit: “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”

¹¹ Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FEF

¹² Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO

¹³ Shtojca 2.5 Rregullorja e programit të studimit: “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”

	teorike dhe praktike për përgatitjen e specialistëve në kulturë dhe media. ¹⁴			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve të mësipërme, konstatohet se programi i studimit "Master i Shkencave" në "Kulturë, media dhe editim" përputhet me misionin dhe strategjitë e Universitetit "Fan S. Noli" si dhe me dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Ai mbështet ruajtjen e vlerave kulturore dhe akademike, duke siguruar ekuilibër mes formimit teorik dhe praktik, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030. Kështu, vlerësojmë se ky standard përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti "Fan S. Noli" demonstroi një përvojë të gjatë dhe kapacitete të konsoliduara në fushën akademike të kulturës, medias dhe editimit, duke mbështetur ofrimin e programit "Master i Shkencave" në "Kulturë, media dhe editim" me burime të mjaftueshme akademike dhe infrastrukturore. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë si njësi bazë ka një histori të gjatë akademike dhe aktualisht përbëhet nga 11 pedagogë efektivë (PAE) dhe 12 me kontratë (PAK), të cilët janë të specializuar në fushat e gjuhësisë, letërsisë, kulturës dhe komunikimit. Ky staf akademik, i përbërë nga profesorë, doktorë shkencash dhe lektorë të specializuar, është në përputhje me fushën e studimit dhe garanton një bazë të mirë për mbështetjen e programit.¹⁵ Në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit 2022-2027, institucioni synon të zhvillojë programe që përbushin nevojat e tregut të punës, duke integruar kompetenca praktike dhe duke promovuar kërkimin në fushën e kulturës dhe medias. Mekanizmat e rishikimit periodik të programeve, të bazuara në

¹⁴ Shtojca 2.4 Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë, 2021-2025

¹⁵ Shtojca 4: Të dhëna statistikore për stafin, studentët dhe programin e studimit

	analiza vjetore të departamentit dhe fakultetit, ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike. ^{16,17}
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, vlerësojmë se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (FEF), i cili është njësia kryesore përgjegjëse për administrimin dhe zhvillimin e tij. Fakulteti ka një traditë të gjatë akademike dhe kërkimore në fushat e shkencave të gjuhës, letërsisë, kulturës dhe komunikimit, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për ofrimin e programeve të nivelit të dytë të studimeve. FHF përbëhet nga katër njësi bazë, konkretisht Departamenti i Edukimit, Departamenti i Gjuhëve të huaja, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë dhe Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë, ku të gjithë këta kanë një përputhshmëri të fushave kërkimore me programin e studimit të fjalë. Rrjedhimisht, struktura dhe përmbajtja e programit janë ndërtuar në përputhje me organizimin akademik të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, duke garantuar integrimin e tij brenda profilit akademik dhe kërkimor të njësies kryesore.¹⁸ Programi gjithashtu mbështetet nga strategjia institucionale e zhvillimit të universitetit dhe të fakultetit. Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO (2022-2027) përmend si prioritet zhvillimin e programeve të orientuara drejt fushave të kulturës, medias dhe edukimit, duke siguruar që programet akademike të reflektojnë nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin social e kulturor të rajonit dhe më gjerë.¹⁹ Nga ana akademike, FHF ka një bazë të fortë kërkimore, me staf akademik të kualifikuar, duke përfshirë profesorë, doktorë shkencash dhe pedagogë të specializuar në fushat e kulturës, medias dhe studimeve letrare.²⁰ Programi përfiton nga ky mjedis akademik i konsoliduar, duke e pozicionuar atë si një vlerë të shtuar brenda njësies kryesore.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e	Programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit të

¹⁶ Shtojca 2.21: Analiza vjetore e veprimtarisë së njësies bazë - departamentit

¹⁷ Shtojca 2.20: Analiza vjetore e veprimtarisë së FEF

¹⁸ Shtojca 2.2 – Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF

¹⁹ Shtojca 1.3 – Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO (2022-2027)

²⁰ Shtojca 4: Të dhëna statistikore për stafin, studentët dhe programin e studimit



programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Gjuhës dhe Letërsisë, i cili është njësia bazë përgjegjëse për programin. Ky departament ka një traditë të konsoliduar në studimet gjuhësore, letrare dhe kulturore, duke reflektuar një orientim të qartë drejt disiplinave të lidhura me analizën e mediave, studimet kulturore dhe praktikën editoriale. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë, si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi, ofron programet e mëposhtme: – Bachelor në Gjuhë-Letërsi – Bachelor në Gjuhë-Letërsi shqipe dhe gjuhë pakicash – Master i Shkencave në Kulturë, Media dhe Editim – Master Profesional në Mësues për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi – Program Profesional 2-vjeçar “Mbështetës Zyre për Komunikim, Bibliotekë dhe Arkivë”. Përmes këtyre programeve, departamenti mbulon fushat e studimeve gjuhësore, kulturore dhe të komunikimit, duke siguruar një bazë akademike për zhvillimin e programit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”. Ky program zgjeron gamën e studimeve të njësisë bazë, duke integruar kërkimin shkencor, studimet kulturore dhe analizën e medias me praktika të avancuara editoriale dhe të komunikimit. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë është një prej katër departamenteve që përbëjnë Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, duke garantuar një përputhje të plotë të programit me strukturën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore.
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet në rastin e këtij programi studimi.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UNIKO demonstroi një qasje aktive në mbështetjen e zhvillimit profesional të studentëve të diplomuar, duke ofruar mundësi trajnimi dhe duke bashkëpunuar me punëdhënësit në fusha të ndryshme. Në vetvete, programi i studimit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” përfshin praktika profesionale të strukturuar, të realizuara në bashkëpunim me institucione publike

	dhe private, duke u mundësuar studentëve të fitojnë aftësi praktike të aplikueshme në tregun e punës. Nga ana tjetër, referuar analizës vjetore të “Qendrës së Karrierës dhe Alumnit”, por edhe të dhënave të mbledhura gjatë vizitës në institucion, u vu re se kjo zyrë organizon aktivitete të vazhdueshme për mbështetjen e integritit të studentëve në tregun e punës, ndërsa bashkëpunimet me punëdhënësit reflektohen në raportet vjetore të institucionit.²¹ Studentët e diplomuar, gjatë vizitës sonë konfirmuan se kanë marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga institucioni me aktorë të ndryshëm të tregut të punës, duke vlerësuar përpjekjet për zhvillimin e tyre profesional. Ndërkohë, raporti mbi ndikimin e bashkëpunimeve institucionale tregon se praktikat dhe trajnimet e ofruara ndihmojnë në përgatitjen e studentëve për tregun e punës.²² Përputhshmëria e programit me Listën Kombëtare të Profesioneve²³ siguron që studentët të jenë të kualifikuar për pozicione profesionale në kulturë, media, arkiva dhe institucione të tjera të ngjashme. Në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, vlerësojmë se institucioni ka synuar të promovojë një qasje të vazhdueshme në edukimin profesional, duke krijuar ura lidhëse mes arsimit dhe punësimit. Këto masa janë në përputhje me kërkesat e kriterit dhe ndihmojnë në sigurimin e një integriteti më të lehtë të studentëve të diplomuar në tregun e punës.			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve të mësipërme, vlerësojmë se programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe asaj bazë, duke reflektuar një përputhje të mirë midis fushës së studimit dhe ekspertizës së stafit akademik. Institucioni demonstroi përvojë të konsoliduar dhe burime të përshtatshme akademike, ndërsa programi është strukturuar në përputhje me praktikat kombëtare dhe evropiane. Gjithashtu, përfshirja e mekanizmave të trajnimit dhe bashkëpunimit me punëdhënësit për studentët e diplomuar është një aspekt pozitiv që forcon lidhjen e programit me tregun e punës. Për rrjedhojë, standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²¹ Shtojca 3.24 – Analiza vjetore e Qendrës së Karrierës dhe Alumnit

²² Shtojca 3.6 – Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit

²³ Shtojca 3.13 – Studim tregu pune periodik në kuadër të hapjes së programit të studimit



Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Universiteti “Fan S. Noli” ka krijuar një sistem të mirëorganizuar për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”, duke siguruar një ndarje të qartë të përgjegjësiwe midis njësive akademike dhe administrative. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (FEF) dhe Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë (DGJL) bashkëpunojnë ngushtë për të garantuar që programi zhvillohet në përputhje me objektivat akademike dhe kërkimore të institucionit. Statuti i Universitetit²⁴ dhe Rregullorja e organizimit të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore²⁵ përcaktojnë qartë mekanizmat e brendshëm të bashkëpunimit dhe ndarjes së detyrave. Në këtë kuadër, Raporti i Analizës Vjetore të Njesisë Bazë²⁶ dhe Raportet e NJSBC²⁷ shërbejnë për të monitoruar performancën e programit dhe për të identifikuar mundësi për përmirësime të vazhdueshme. Po ashtu, Rregullorja e Njesisë Bazë përcakton mënyrën se si Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë siguron cilësinë akademike dhe kërkimore të programit.²⁸
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Universiteti “Fan S. Noli” ka vendosur marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të sektorit privat dhe publik, për të mbështetur zhvillimin e objektivave të programit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”. Në nivel institucional, universiteti ka një rrjet të gjerë partneritetesh me universitete evropiane dhe rajonale përmes programeve të mobilitetit akademik si Erasmus+, si dhe pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare si Horizont 2020 dhe CBC. Këto iniciativa u mundësojnë studentëve dhe stafit akademik mundësi të zgjeruara

²⁴ Shtojca 1. 1. Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”

²⁵ Shtojca 2.2. Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF

²⁶ Shtojca 2.21 Analiza vjetore e veprimtarisë së njesisë bazë

²⁷ Shtojca 3.7 Raportet vjetore të NJSBC

²⁸ Shtojca 2.3 Rregullorja e njesisë bazë (DGJL)

	për zhvillim profesional dhe kërkim shkencor, duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies dhe përvojën akademike.²⁹ Përveç marrëdhënieve akademike, institucioni ka vendosur bashkëpunime me aktorë të tregut të punës për të lehtësuar integrimin e studentëve në sektorin kulturor dhe mediatik. “Argumentim i hapjes së programit MSc në ‘Kulturë, media dhe editim’” (Shtojca 3.13.1) dëshmon mbi analizën e tregut dhe përputhjen e programit me nevojat profesionale në këto fusha. Për më tepër, marrëveshjet me institucione vendase dhe ndërkombëtare sigurojnë mundësi për trajnime, praktika profesionale dhe projekte të përbashkëta, duke ndihmuar në formimin e specialistëve të ardhshëm të kulturës dhe medias. Në kuadër të Planit Strategjik të Zhvillimit 2022-2027, Universiteti “Fan S. Noli” ka prioritet zgjerimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe thellimin e bashkëpunimeve me institucione kërkimore dhe akademike, duke synuar të integrojë praktikën më të mira evropiane në arsimin e lartë.³⁰ Nga sa mësipër, vlerësojmë se institucioni ka siguruar një rrjet të gjerë bashkëpunimi me universitete dhe institucione të tjera, duke garantuar përmbushjen e objektivave akademike dhe profesionale të programit, si dhe duke ndihmuar studentët në aftësimin dhe përfshirjen e tyre në tregun e punës.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e	Bazuar në evidencat e paraqitura nga institucioni, por edhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në të, u konstatua se Universiteti “Fan S. Noli” ka krijuar një rrjet të gjerë bashkëpunimesh me institucione kërkimore, kompani dhe organizata të fushave përkatëse, duke garantuar një infrastrukturë të strukturuar për zhvillimin e praktikave profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit akademik. Aktualisht, universiteti ka mbi 50 marrëveshje me institucione rajonale, 97 marrëveshje kombëtare dhe 35 marrëveshje ndërkombëtare, të cilat sigurojnë një platformë të qëndrueshme për aftësimin praktik të studentëve dhe zhvillimin profesional të stafit akademik.³¹ Në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO (2022-2027), universiteti ka synuar të fuqizojë përfshirjen e aktorëve të

²⁹ Shtojca 2.21 - Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë (departamentit) - Mobilitetet

³⁰ Shtojca 1.3 - Planin Strategjik i Zhvillimit të UNIKO

³¹ Shtojca 2.10 - Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	tregut të punës në programet akademike, duke u fokusuar në krijimin e një lidhjeje të qëndrueshme midis arsimit të lartë dhe nevojave të industrisë.³² Në këtë kontekst, bashkëpunimet me kompanitë e sektorëve të kulturës, medias dhe editimit ndihmojnë studentët të fitojnë përvojë praktike përmes praktikave të mbikëqyrura nga punëdhënësit dhe institucione të specializuara. Ndërkohë, mobiliteti akademik përbën një tjetër aspekt të rëndësishëm të strategjisë së bashkëpunimit të universitetit. Përmes Erasmus+, Horizont 2020 dhe partneriteteve me rrjete akademike ndërkombëtare, rezulton se studentët dhe stafi kanë pasur mundësi të angazhohen në projekte të përbashkëta kërkimore dhe shkëmbime akademike, duke rritur ndjeshëm ndërkombëtarizimin e programit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”.³³ Përveç praktikave profesionale dhe mobilitetit, universiteti ka ndërtuar një mekanizëm të rregullt vlerësimi të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, duke analizuar impaktin e tyre në përgatitjen e studentëve dhe në integrimin e tyre në tregun e punës. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit dëshmon mbi efektivitetin e këtyre bashkëpunimeve dhe rëndësinë e tyre në formimin profesional të studentëve.³⁴
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”, kryen analiza periodike mbi përfitimet e marra nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Këto analiza ndihmojnë në monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të bashkëpunimeve në cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimit profesional të studentëve. Në këtë drejtim, raportet e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe analizat vjetore të departamentit përmbajnë të dhëna mbi rezultatet konkrete të marra nga marrëveshjet institucionale, përfshirë mobilitetin akademik, praktikat profesionale dhe projektet e përbashkëta kërkimore.^{35,36}

³² Shtojca 1.3 - Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO

³³ Shtojca 2.19 - Mobilitete staf ERASMUS+

³⁴ Shtojca 3.6 - Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit

³⁵ Shtojca 3.7 - Raportet vjetore të NJSBC

³⁶ Shtojca 2.21 - Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë (departamentit)

	Gjithashtu, rezulton se institucioni ka krijuar një bazë të dhënash për të mbledhur dhe përpunuar informacionin mbi marrëveshjet e bashkëpunimit, e cila ndihmon në përgatitjen e raporteve vjetore dhe përcaktimin e strategjive të ardhshme. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit ofron një analizë të detajuar mbi ndikimin e këtyre partneriteteve.³⁷ Nga sa më sipër vlerësojmë se, universiteti ka ndërtuar një mekanizëm të mirëorganizuar të raportimit dhe vlerësimit të bashkëpunimeve, duke siguruar që marrëveshjet të kenë ndikim të qartë dhe të matshëm në realizimin e objektivave të programit.			
Konkluzione	<i>Universiteti "Fan S. Noli" demonstroi një angazhim të strukturuar dhe efektiv në sigurimin e bashkëpunimeve institucionale, duke garantuar që programi "Master i Shkencave" në "Kulturë, media dhe editim" mbështetet nga marrëveshje konkrete me institucione akademike dhe aktorë të tregut të punës. Institucioni ka krijuar një rrjet të gjerë partneritetesh kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat ndihmojnë në realizimin e praktikave profesionale, kërkimin shkencor dhe mobilitetin e stafit dhe studentëve. Për më tepër, mekanizmat e raportimit dhe vlerësimit të përfitimeve nga këto bashkëpunime janë të konsoliduara, duke siguruar përmirësim të vazhdueshëm dhe përputhshmëri me objektivat akademike dhe profesionale të programit. Në këtë kontekst, standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

³⁷ Shtojca 3.6 - Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit

Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” është ndërtuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), duke siguruar një strukturë të qartë dhe të përcaktuar qartë për veprimtaritë formuese dhe kreditet. Programi përbëhet nga 120 kredite ECTS, të shpërndara në katër semestra, ku çdo kredit përfaqëson 25 orë punë akademike, duke përfshirë mësimdhënien në auditor dhe angazhimin e pavarur të studentëve.³⁸ Struktura e programit është ndërtuar sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar për arsimin e lartë, duke garantuar përputhshmërinë me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare.³⁹ Elementët që përbëjnë strukturën e programit janë të qartë dhe të përcaktuar saktësisht, duke përfshirë pesë kategori lëndësh: A. Lëndë të formimit të përgjithshëm – 11 ECTS, rreth 9% B. Lëndë karakterizuese – 64 ECTS, rreth 53 % C. Lëndë ndërdisiplinore – 20 ECTS, rreth 17% D. Lëndë plotësuese – 13 ECTS, rreth 11% E. Detyime përmbyllëse – 12 ECTS, rreth 10%⁴⁰ Ky organizim siguron balancën midis formimit teorik dhe aftësimit profesional, duke reflektuar kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore akademike. Përveç lëndëve teorike dhe ndërdisiplinore, programi përfshin edhe praktikën profesionale, e cila është një komponent i rëndësishëm formues dhe zhvillohet në bashkëpunim me institucione dhe organizata relevante në fushën e kulturës dhe medias. Procedurat dhe objektivat e praktikës janë të përcaktuara qartë në udhëzuesin përkatës.⁴¹ Gjithashtu, për të garantuar transparencën akademike dhe lehtësinë e njohjes së diplomës në sistemin ndërkombëtar, programi shoqërohet me suplementin e diplomës, i cili përmban informacion mbi strukturën dhe përmbajtjen akademike.⁴²
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive	Referuar të dhënave të paraqitura nga institucioni, vlerësojmë se programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”

³⁸ Shtojca 2.7 – Plani mësimor i programit të studimit

³⁹ Shtojca 2.5 – Rregullorja e programit të studimit: “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”

⁴⁰ Shtojca 4: Të dhëna statistikore për stafin, studentët dhe programin e studimit

⁴¹ Shtojca 2.15 – Udhëzues i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë mbi praktikën mësimore/institucionale

⁴² Shtojca 2.6 – Modeli i Suplementit të Diplomës



të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	synon formimin e njohurive të thelluara dhe aftësive të përparuara në fushën e kulturës dhe medias, duke ofruar një bazë teorike dhe praktike për studentët. Programi është konceptuar për të zhvilluar një të kuptuar kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, si dhe për të pajisur studentët me kompetenca të avancuara për të analizuar dhe zgjidhur probleme komplekse në kontekst profesional dhe akademik. Në këtë drejtim, përmbajtja akademike përfshin lëndë që mbulojnë analizën e thelluar të zhvillimeve kulturore dhe mediatike, duke nxitur një qasje ndërdisiplinore dhe aplikative.⁴³ Programi është i strukturuar për të siguruar që studentët jo vetëm të zotërojnë njohuri teorike, por edhe të zhvillojnë aftësi praktike, të cilat janë të nevojshme për sfida të paparashikueshme në fushën e studimit. Për këtë arsye, përfshirja e praktikave profesionale në bashkëpunim me institucione dhe organizata të sektorit ndihmon në forcimin e kompetencave të studentëve për zbatimin e njohurive në situata reale të punës.⁴⁴ Gjithashtu, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, programi garanton që rezultatet e të nxënit janë të orientuara drejt përgatitjes së profesionistëve të aftë për t'u integruar në sektorin kulturor dhe mediatik. Një komponent i rëndësishëm i programit është përgatitja e temës së diplomës, e cila synon të zhvillojë aftësi të avancuara kërkimore dhe analizë të thelluar të problematikave bashkëkohore në fushën e kulturës dhe medias.⁴⁵
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, konstatohet se programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” ka një ndarje të qartë të krediteve për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, duke siguruar balancën mes formimit teorik dhe përvojës praktike. Në këtë kuadër, plani mësimor⁴⁶ përfshin ‘Praktikën profesionale’ dhe ‘Tezën dhe kërkimin’. Praktika profesionale (6 ECTS) synon të pajisë studentët me aftësi të aplikueshme në institucione mediatike, kulturore dhe botuese.

⁴³ Shtojca 2.8 – Programet lëndore të programit të studimit

⁴⁴ Shtojca 2.10 – Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

⁴⁵ Shtojca 2.14 – Udhëzues i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë për punimin e diplomës

⁴⁶ Shtojca 2.7 – Plan i mësimor i programit të studimit

	Praktikat organizohen në bashkëpunim me aktorë të industrisë, siç pasqyrohet në marrëveshjet e bashkëpunimit.⁴⁷ Teza (9 ECTS), përbën fazën përmbyllëse të studimeve dhe ka në fokus kërkimin e avancuar, analizën kritike dhe aplikimin e metodologjive shkencore në fushën e kulturës dhe medias. Përmbajtja dhe procedurat për realizimin e tezës janë të përcaktuara në Udhëzuesin për Punimin e Diplomës.⁴⁸ Duke marrë në konsideratë këto elemente, vlerësojmë se programi është ndërtuar në përputhje të plotë me kërkesat e kriterit, duke siguruar qartësi në strukturën e krediteve për komponentët praktikë dhe akademikë.
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet në rastin e këtij programi studimi.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet në rastin e këtij programi studimi.

⁴⁷ Shtojca 2.10 – Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

⁴⁸ Shtojca 2.15 – Udhëzues i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë mbi Praktikën Mësimore/Institucionale

Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nuk aplikohet në rastin e këtij programi studimi.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Struktura dhe përmbajtja akademike e programit tregojnë se “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” është një program unik në fushën e tij, pa një ekuivalent të drejtpërdrejtë në universitetet e tjera shqiptare. Ky program është hartuar në përputhje me kërkesat specifike të tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e kulturës dhe medias, duke përfshirë një balancë mes lëndëve teorike dhe praktike. Lëndët e specializuara dhe qasja ndërdisiplinore e dallojnë atë nga programet e tjera akademike të ngjashme.⁴⁹ Në përputhje me kriterin, programi ka një profil të qartë dhe të diferencuar, duke reflektuar një qasje të mirëstrukturuar akademike dhe profesionale.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” është i kodifikuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Kodifikimi është kryer në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 11.05.2022, dhe Udhëzimin nr. 31, datë 15.11.2022, duke siguruar përputhshmërinë me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (niveli 7) dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).⁵⁰ Kodi përkatës i programit është 72MS0300S.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë	Nuk aplikohet për këtë program studimi.

⁴⁹ Shtojca 2.7 – Plani mësimor i programit të studimit

⁵⁰ Shtojca 3.4 – Shkresa për kodifikimin e programit të studimit

institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>Nga sa më sipër, vlerësojmë se struktura dhe përmbajtja e programit janë të qarta dhe të përcaktuara sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), duke siguruar formimin e kompetencave të përparuara akademike dhe profesionale. Ngarkesa në kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse është e përcaktuar saktësisht, ndërsa programi është një risi në ofertën akademike të institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, kodifikimi i programit dhe lëndëve është realizuar sipas rregulloreve në fuqi, duke garantuar transparencë dhe përputhshmëri me kërkesat institucionale dhe ligjore. Rrjedhimisht, programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” përmbush plotësisht kërkesat e këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, vlerësimin dhe akreditimin. Struktura organizative e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (FEF) dhe departamentit është në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, si dhe me aktet e brendshme rregullatore të Universitetit “Fan S. Noli”.⁵¹ Stafi akademik i departamentit përbëhet: - 2022-2023, 11 PAE (2 Prof. Dr., 3 Prof. As., 5 Dr., dhe 1 Msc) dhe 12 PAK (3 Prof. As., 5 Dr., 4 Msc); - 2023-2024, 11 PAE (2 Prof. Dr., 4 Prof. As., 4 Dr., dhe 1 Msc) dhe 12 PAK (3 Prof. As., 5 Dr., 4 Msc);

⁵¹ Shtojca 1 – Statuti i Universitetit “Fan S. Noli, Neni 8

	duke siguruar një mbulim cilësor të disiplinave të programit dhe përmbushjen e standardeve akademike dhe kërkimore.⁵² Në funksion të sigurimit të cilësisë, NJSBC zhvillon monitorime të vazhdueshme dhe përgatit raporte periodike për përmirësimin e programit.⁵³ Ndërkohë, ky është procesi i parë i akreditimit për programin “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”, i cili po zhvillohet në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë. Dokumentimi dhe mbështetja institucionale e këtij procesi reflektohen në vendime zyrtare të universitetit.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë (DGJL) përmbush detyrimet ligjore për organizimin dhe mbështetjen e praktikave mësimore, duke angazhuar personel ndihmës akademik dhe administrativ në funksion të realizimit të tyre. Ky proces bazohet në rregulloret e universitetit dhe në bashkëpunimin me institucione të sektorit kulturor dhe mediatic.⁵⁴ Roli i këtij personeli është i qartë në Rregulloren e Programit të Studimit dhe Udhëzuesin për Praktikat Profesionale, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për mbikëqyrjen e praktikave dhe vlerësimin e performancës së studentëve.⁵⁵ Monitorimi i këtij procesi kryhet përmes NJSBC, duke siguruar përmirësim të vazhdueshëm dhe përshtatje me nevojat akademike dhe profesionale.⁵⁶
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinаторit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Roli i koordinatorit të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” është i përcaktuar qartë dhe përputhet me kërkesat ligjore dhe institucionale për arsimin e lartë. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë ka ndjekur një procedurë të rregullt për emërimin e koordinatorit, duke miratuar vendimin në njësinë bazë dhe duke e formalizuar atë në nivel fakulteti.⁵⁷ Përgjegjësitë e koordinatorit përfshijnë mbikëqyrjen e kurrikulës, organizimin dhe monitorimin e praktikave profesionale, si dhe raportimin periodik mbi zhvillimin e programit.⁵⁸

⁵² Shtojca 4 – Të dhëna statistikore mbi stafin, studentët dhe programin e studimit

⁵³ Shtojca 3.7 – Raportet vjetore të NJSBC

⁵⁴ Shtojca 2.10 – Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

⁵⁵ Shtojca 2.15 – Udhëzuesi mbi praktikën mësimore/institucionale

⁵⁶ Shtojca 3.7 – Raportet vjetore të NJSBC

⁵⁷ Shtojca 2.11.2 – Vendimi i njësisë bazë për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimit

⁵⁸ Shtojca 2.5 – Rregullorja e programit të studimit

Konkluzione	<i>Nga sa më sipër, vlerësojmë se programi i studimit "Master i Shkencave" në "Kulturë, media dhe editim" përmbush plotësisht kërkesat e këtij standardi. Si FHF, po ashtu edhe DGjL, si njësi bazë përgjegjëse, siguron organizimin dhe strukturën akademike në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke angazhuar një staf të kualifikuar akademik dhe ndihmës për realizimin e praktikave dhe veprimtarive mësimore. Institucioni ka caktuar një koordinator të programit, i cili mbikëqyr ecurinë akademike, duke garantuar zhvillimin e programit sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin "Master i Shkencave" në "Kulturë, media dhe editim," disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e tij. Këto informacione janë të dokumentuara në Planin Mësimor (Shtojca 2.7), Rregulloren e Programit të Studimit (Shtojca 2.5), si dhe në programet lëndore që përmbajnë përshkrime të detajuara mbi metodologjinë e mësimdhënies dhe objektivat akademike (Shtojca 2.8). Departamenti ndjek një proces të strukturuar për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e programit, duke garantuar që të dhënat mbi organizimin dhe përmbajtjen e tij të përditësohen dhe të jenë të aksesueshme për stafin akademik dhe studentët. Për më tepër, arkivimi dhe dokumentimi i aktiviteteve akademike dhe kërkimore siguron një menaxhim të qartë të programit në përputhje me standardet institucionale dhe ligjore (Shtojca 2.3, Shtojca 4.1).
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën	Plani mësimor i programit "Master i Shkencave" në "Kulturë, media dhe editim" është i strukturuar qartë dhe përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të secilës lëndë/modul dhe shpërndarjen e orëve ndërmjet leksioneve, seminareve dhe punës individuale të studentëve.⁵⁹ Programi ndjek Sistemin Evropian të Transferimit dhe

⁵⁹ Shtojca 2.7 – Plani mësimor i programit të studimit

mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Grumbullimit të Krediteve (ECTS), duke përcaktuar qartë numrin e krediteve për çdo lëndë në përputhje me ngarkesën akademike të studentëve. Rregullorja e programit (Shtojca 2.5) dhe syllabuset e lëndëve (Shtojca 2.8) sigurojnë transparencë të plotë mbi përmbajtjen dhe metodologjinë e mësimdhënies, duke garantuar një strukturë të organizuar dhe të përputhshme me kërkesat ligjore dhe akademike.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet e nevojshme për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin “Master i Shkencave” në “Kulturë, Media dhe Editim” janë të përcaktuara qartë në dokumentet rregullatore të institucionit. Rregullorja e programit (Shtojca 2.5) specifikon kushtet për pranimin e studentëve, përfshirë kërkesat akademike dhe procedurat e aplikimit. Transferimi i krediteve dhe ekuivalentimi i studimeve kryhen sipas praktikave të miratuara nga universiteti dhe në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (Shtojca 2.16), duke garantuar një proces të rregullt dhe të unifikuar për të gjithë kandidatët. Këto procedura sigurojnë transparencë dhe barazi në vlerësimin e kandidatëve, duke krijuar mundësi të qarta për studentët që dëshirojnë të ndjekin ose të vazhdojnë studimet në këtë program.
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Kulturë, Media dhe Editim” përmban të gjitha programet lëndore (syllabuset).⁶⁰ Syllabuset për secilën lëndë përfshijnë informacionin e nevojshëm mbi objektivat akademike, ndarjen e ngarkesës mesimore në auditor dhe jashtë auditorit, numrin e krediteve (ECTS), formën e vlerësimit dhe bibliografinë bazë. Këto dokumente rishikohen dhe përditësohen në fillim të çdo viti akademik për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e studimit. Publikimi i syllabuseve u mundëson studentëve të njihen paraprakisht me përmbajtjen dhe metodologjinë e mësimdhënies, duke siguruar transparencë dhe qasje të qartë në programin akademik. <i>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, rekomandohet që syllabuset e lëndëve të harmonizohen me aktet rregullatore në fuqi dhe të unifikohen në një format të standardizuar në nivel institucioni. Kjo do të sigurojë koherencë në strukturën dhe përmbajtjen e tyre, si dhe përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe akademike të sistemit të arsimit të lartë.</i>

⁶⁰ Shtojca 2.8 - Programet lëndore të programit të studimit

Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, por edhe të dhënave të mbledhura gjatë vizitës atjem konstatojmë se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Kulturë, Media dhe Editim” siguron përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së tij, duke reflektuar nevojat akademike dhe kërkesat e tregut të punës. Çdo vit akademik, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë realizon një rishikim të hollësishëm të planit mësimor dhe syllabuseve, bazuar në analizën vjetore të aktivitetit akademik dhe feedback-un e stafit dhe studentëve.^{61,62} Ndryshimet eventuale miratohen nga Departamenti dhe reflektohen në dokumentet përkatëse, si syllabuset e lëndëve dhe rregullorja e programit.^{63,64} Për të garantuar transparencën dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare, dosja e plotë e programit arkivohet në shqip dhe anglisht, duke përfshirë të gjitha dokumentet kryesore akademike. Ky proces i vazhdueshëm i përmirësimit dhe përditësimit siguron që programi të mbetet në harmoni me zhvillimet më të fundit në fushat e kulturës, medias dhe editimit, duke ruajtur standardet e larta akademike dhe duke përmbushur objektivat formues të tij.			
Konkluzione	<i>Bazuar në të dhënat dhe evidencat e paraqitura, vlerësohet se Standardi II.3 përmbushet plotësisht. Programi i studimit është i detajuar dhe i organizuar në përputhje me objektivat formues të ciklit të dytë, duke siguruar informacion të qartë mbi organizimin, strukturën, ngarkesën mësimore dhe komponentët formues. Gjithashtu, procedurat për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve janë të dokumentuara dhe të aksesueshme, ndërsa syllabuset dhe dokumentacioni përkatës pasqyrojnë transparencën dhe përditësimin e vazhdueshëm të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

⁶¹ Shtojca 3.7 – Raportet vjetore të NJSBC

⁶² Shtojca 3.15 – Pyetësi i stafit akademik

⁶³ Shtojca 2.8 – Programet lëndore të programit të studimit

⁶⁴ Shtojca 2.12 – Procedura e ndryshimeve në planin mësimor (Rishikimi i kurrikulës)

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Konstatohet se ky program i studimit siguron një strukturë të qartë akademike dhe profesionale që mbështet thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të studentëve për studime të mëtejshme dhe/ose punësim. Përmbajtja e programit, e reflektuar në planin mësimor⁶⁵ dhe rregulloren e programit⁶⁶, është hartuar në përputhje me standardet akademike dhe kërkesat e tregut të punës. Shpërndarja e lëndëve, si dhe organizimi i praktikave profesionale⁶⁷, ofron një kombinim të ekuilibruar midis përgatitjes teorike dhe aftësive të zbatueshme në kontekste të ndryshme profesionale. Gjithashtu, të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve⁶⁸ konfirmojnë se programi ka një ndikim të drejtpërdrejtë në aftësimin e studentëve për tregun e punës. Për rrjedhojë, programi i studimit përmbush kërkesat e kriterit, duke garantuar një qasje gjithëpërfshirëse për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Struktura e programit të studimit⁶⁹ siguron një shpërndarje të balancuar të lëndëve në vite dhe semestra, duke garantuar që studentët të arrijnë objektivat formues dhe rezultatet e pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Me një ngarkesë prej 120 krediteve ECTS të ndara në katër semestra dhe një ngarkesë prej 30 kreditesh për semester, programi është plotësisht i përshtatur me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe standardet akademike ndërkombëtare. Përmbajtja e lëndëve reflekton një kombinim të lëndëve bazë, të cilat sigurojnë një themel teorik të fuqishëm, dhe lëndëve karakterizuese dhe ndërdisiplinore, që lehtësojnë përvetësimin e aftësive të specializuara në menaxhimin kulturor, analizën mediatike dhe botimet⁷⁰. Integrimi i praktikave profesionale⁷¹ ndihmon në forcimin e aftësive praktike, duke ofruar studentëve mundësi për të aplikuar njohuritë në mjedise reale pune.

⁶⁵ Shtojca 2.7 - Plani mësimor i programit të studimit

⁶⁶ Shtojca 2.5 - Rregullorja e programit të studimit

⁶⁷ Shtojca 2.10 - Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

⁶⁸ Shtojca 3.25 - Të dhëna mbi gjurmimin/punësimin e studentëve që kanë përfunduar programin

⁶⁹ Shtojca 2.7 - Plani Mësimor i Programit të Studimit: Master i Shkencave në "Kulturë, Media dhe Editim"

⁷⁰ Shtojca 2.5 - Rregullorja e Programit të Studimit: Master i Shkencave në "Kulturë, Media dhe Editim"

⁷¹ Shtojca 2.10 - Marrëveshje Bashkëpunimi në Mbështetje të Praktikave Profesionale

	Shpërndarja e orëve mësimore, si dhe metodat e vlerësimit, janë të qarta dhe pasqyrohen në Programet Lëndore të Programit të Studimit (syllabuset)⁷² të cilat përditësohen rregullisht në përputhje me zhvillimet akademike dhe nevojat e tregut të punës⁷³. Bazuar në këto elemente, programi i studimit përmbush në mënyrë të plotë kërkesat e këtij kriteri, duke siguruar një strukturë të mirëorganizuar dhe efikase për formimin akademik dhe profesional të studentëve.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e programit të studimit është ndërtuar duke ruajtur një balancë të qartë midis komponentëve teorikë dhe praktikë, duke siguruar përputhshmëri me profilin akademik dhe profesional të programit. Përmbajtja e lëndëve dhe raporti midis orëve të leksioneve dhe praktikave janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit, duke ofruar një bazë të fortë teorike, e cila plotësohet me përvojën praktike në institucione të kulturës dhe medias.⁷⁴ Programi është i përafërt me strukturat e programeve ndërkombëtare në të njëjtën fushë, siç është reflektuar në analizat e bëra përmes programeve të mobilitetit Erasmus+, ku janë krahasuar lëndët dhe format e organizimit akademik me ato të universiteteve partnere.⁷⁵
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Po, struktura e programit “Master i Shkencave në Kulturë, Media dhe Editim” siguron një balancë të mirëorganizuar midis komponentëve teorikë dhe praktikë, duke garantuar zhvillimin e aftësive të specializuara dhe përgatitjen e studentëve për punësim dhe mobilitet akademik. Shpërndarja e lëndëve pasqyron një përputhje të qartë me kërkesat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, duke mbuluar fusha si media, botimet dhe menaxhimi kulturor.⁷⁶ Programi është i përshtatur me standardet ndërkombëtare, çka lehtëson transferimin e krediteve dhe mobilitetin akademik në kuadër të programeve si Erasmus+⁷⁷. Përveç kësaj, analiza e të diplomuarve tregon se shumica e studentëve kanë gjetur punësim në

⁷² Shtojca 2.8 – Programet Lëndore të Programit të Studimit: Master i Shkencave në “Kulturë, Media dhe Editim”

⁷³ Shtojca 3.7 – Raportet Vjetore të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)

⁷⁴ Shtojca 2.5 – Rregullorja e Programit të Studimit: Master i Shkencave në “Kulturë, Media dhe Editim”

⁷⁵ Shtojca 2.19 – Mobilitetet e Stafit Erasmus+

⁷⁶ Shtojca 2.5 – Rregullorja e Programit të Studimit: Master i Shkencave në “Kulturë, Media dhe Editim”

⁷⁷ Shtojca 2.19 – Mobilitetet e Stafit Erasmus+

	fushat e medias dhe kulturës, ose kanë avancuar në pozicionet e tyre profesionale ⁷⁸ .
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Gjatë intervistave me drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore, si dhe me stafin akademik, u konfirmua se përditësimi i syllabuseve është një proces i vazhdueshëm, i cili realizohet në përputhje me standardet akademike dhe kërkesat e tregut të punës. Syllabuset përmbajnë informacion të detajuar, duke përfshirë objektivat e lëndës, përmbajtjen tematike, metodat e vlerësimit dhe literaturën e rekomanduar, e cila përditësohet për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e medias, kulturës dhe editimit⁷⁹. Në fillim të çdo viti akademik, titullarët e lëndëve kryejnë një rishikim të materialeve mësimore, duke siguruar që programi të mbetet i përshtatur me tendencat ndërkombëtare dhe zhvillimet teknologjike. Ky përditësim mbështetet nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë, i cili monitoron cilësinë dhe relevancën e përmbajtjes akademike⁸⁰.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Referuar vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni, vlerësojmë se struktura dhe përmbajtja e programit të studimit “Master i Shkencave në Kulturë, Media dhe Editim” siguron një kombinim të ekuilibruar të njohurive akademike, aftësive analitike dhe kompetencave praktike, duke qenë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe standardet akademike kombëtare dhe ndërkombëtare. Lëndët kryesore dhe ato karakterizuese janë të hartuara për të zhvilluar aftësi të thelluara analitike dhe kritike, ndërsa literatura bazë dhe ndihmëse përditësohet për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën përkatëse⁸¹. Syllabuset e përditësuara për secilën lëndë përcaktojnë objektivat e formimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe metodat e vlerësimit, duke siguruar një strukturë të qartë për përmbajtjen akademike⁸². Përmbajtja e programit pasqyron një ndarje të qartë midis formimit teorik dhe praktik, duke përfshirë praktika profesionale dhe projekte kërkimore që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të aplikuara dhe në përgatitjen për sfidat e tregut të punës⁸³.

⁷⁸ Shtojca 3.24 – Analiza Vjetore e Qendrës së Karrierës dhe Alumni

⁷⁹ Shtojca 2.8 – Programet Lëndore të Programit të Studimit

⁸⁰ Shtojca 2.12 – Procedura e Ndryshimeve në Planin Mësimor (Rishikimi i Kurrikulës)).

⁸¹ Shtojca 2.5 – Rregullorja e Programit të Studimit: Master i Shkencave në “Kulturë, Media dhe Editim:

⁸² Shtojca 2.8 – Programet Lëndore të Programit të Studimit

⁸³ Shtojca 2.7 – Planin Mësimor i Programit të Studimit

	Ndërkohë, edhe përmirësimet periodike të programit bazuar në analizat vjetore të njësisë bazë sigurojnë që përmbajtja e programit të mbetet në përputhje me zhvillimet akademike dhe nevojat e studentëve⁸⁴.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Po, vlerësojmë se ky program studimi është projektuar për të mundësuar vazhdimin e studimeve të mëtejshme dhe integrimin efektiv të studentëve në tregun e punës. Përmbajtja e kurrikulës është e përditësuar duke reflektuar kërkesat e tregut dhe zhvillimet akademike bashkëkohore⁸⁵. Programi synon të zhvillojë aftësi dhe kompetenca të thelluara në fushën e medias, kulturës dhe editimit, duke ofruar një bazë teorike të fortë dhe komponentë praktikë të integruar, siç vërtetohet nga përfshirja e praktikave profesionale dhe bashkëpunimet me institucione të fushës⁸⁶. Për më tepër, struktura e programit është ndërtuar në mënyrë që të lejojë studentët të ndjekin studime të mëtejshme në nivelin doktoral, duke siguruar përmbushjen e standardeve akademike dhe të kërkimit shkencor për avancim akademik⁸⁷. <i>Megjithatë, vërehet se studimi i tregut të punës mbi nevojat e sektorit fokusohet kryesisht në rajonin e Korçës, duke mos pasqyruar plotësisht kërkesat në një kontekst më të gjerë. Duke qenë se UNIKO tërheq studentë nga e gjithë Shqipëria, do të ishte e dobishme që analizat e ardhshme të tregut të punës të shtrihen në një nivel më të gjerë, duke reflektuar nevojat dhe tendencat kombëtare për një përshtatje më të saktë të programit me kërkesat e tregut profesional.</i>
Konkluzione	Programi i studimit “Master i Shkencave në Kulturë, Media dhe Editim” është i strukturuar dhe i organizuar në përputhje me objektivat formues dhe nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve. Përmbajtja e tij siguron zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të nevojshme për tregun e punës dhe studimet e mëtejshme, ndërsa rishikimi dhe përditësimi periodik garanton përputhshmërinë me kërkesat akademike dhe profesionale.

⁸⁴ Shtojca 3.7 – Raportet Vjetore të Njësisë Bazë

⁸⁵ Shtojca 3.13 – Studim tregu pune periodik/ në kuadër të hapjes së programit të studimit

⁸⁶ Shtojca 2.10 – Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

⁸⁷ Shtojca 2.4 – Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë

	<i>Por, megjithëse programi bazohet në një analizë të tregut të punës, ajo mbetet e kufizuar kryesisht në rajonin e Korçës dhe nuk reflekton nevojat në një nivel më të gjerë. Duke qenë se UNIKO pranon studentë nga e gjithë Shqipëria, rekomandohet që në të ardhmen studimi i tregut të punës të realizohet në një nivel më të gjerë, duke pasqyruar të paktën tendencat dhe kërkesat në nivel kombëtar. Megjithatë, bazuar në evidencat e shqyrtuara dhe vlerësimet tona në lidhje me këto kritere, vlerësojmë se standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecursisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë në Universitetin “Fan S. Noli” ka krijuar një sistem të konsoliduar konsultimi me aktorët kryesorë të tregut të punës, alumni dhe institucionet partnere për të siguruar përshtatjen e programit me kërkesat e sektorit. Ky proces përfshin bashkëpunimet institucionale, që konkretizohen përmes marrëveshjeve me organizata kulturore dhe mediatike⁸⁸, feedback-un nga të diplomuarit⁸⁹, që mblidhet përmes pyetësorëve studentorë dhe analizave të Qendrës së Karrierës⁹⁰; si dhe studimet e tregut të punës, të realizuara në bashkëpunim me aktorët e sektorit⁹¹. Gjithashtu, programi merr në konsideratë praktikatat më të mira ndërkombëtare përmes pjesëmarrjes në rrjete akademike dhe mobilitete Erasmus⁹². Këto mekanizma e bëjnë procesin e përmirësimit të programit të vazhdueshëm dhe të orientuar drejt nevojave të tregut të punës. Gjatë takimit të zhvilluar me anëtarë të personelit akademik dhe me studentë të institucionit, u konstatua se angazhimi i të diplomuarve në funksion të përmirësimit të vazhduar të programit të studimit


⁸⁸ Shtojca 2.10 – Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

⁸⁹ Shtojca 3.14 – Pyetësor studentor

⁹⁰ Shtojca 3.24 – Analiza vjetore Qendra e Karrierës dhe Alumni

⁹¹ Shtojca 3.13 – Studim tregu pune periodik/ në kuadër hapjeje programi studimi

⁹² Shtojca 2.19 – Mobilitetet Staf Erasmus+

  297

	mbetet i kufizuar dhe i fragmentar. Përtej përfshirjes së tyre formale përmes pyetësorëve të përmendur në paketën e instrumenteve të cilësisë, vetë përfaqësuesit pohuan se kontributi i tyre në këto procese rrjedh më tepër nga pranimi i rastësishme në aktivitete me biznese apo aktorë të jashtëm, sesa nga një mekanizëm i strukturuar për vlerësim dhe reflektim të vazhduar. <i>Kjo e bën të nevojshme fuqizimin e përfshirjes aktive të të diplomuarve dhe aktorëve të jashtëm, jo vetëm në funksion të rishikimit të programeve, por edhe në hartimin e politikave të brendshme të sigurimit të cilësisë, në mënyrë që të sigurohet një pasqyrë më gjithëpërfshirëse dhe dinamike e zhvillimit të programeve.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Universiteti “Fan S. Noli” ndjek një qasje të strukturuar për përfshirjen e studentëve dhe strukturave të tyre në diskutimet mbi përmirësimin e programeve të studimit. Studentët dhe përfaqësuesit e tyre, përfshirë Këshillin Studentor, marrin pjesë në proceset e konsultimit përmes takimeve dhe propozimeve të tyre në organet përkatëse ⁹³ . Kjo u konfirmua edhe nga studentët e pranishëm gjatë vizitës sonë në institucion, të cilët vlerësuan mundësinë e tyre për të dhënë sugjerime mbi përmirësimin e kurrikulës. Gjithashtu, institucioni mban kontakte të rregullta me studentët e diplomuar përmes aktiviteteve të organizuara nga Qendra e Karrierës dhe Alumni, e cila mbledh vlerësime dhe sugjerime për programin dhe përshtatshmërinë e tij me tregun e punës ⁹⁴ . Departamenti përkatës organizon gjithashtu takime periodike me studentët aktualë dhe të diplomuar për të diskutuar mbi përvojat e tyre dhe për të identifikuar elementet që duhen përmirësuar në programin e studimit ⁹⁵ . Këto mekanizma sigurojnë që përmirësimi i programit të reflektojë nevojat dhe pritshmëritë e studentëve.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe	Universiteti “Fan S. Noli” dhe Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë angazhohen në përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”, duke reflektuar zhvillimet e fundit akademike dhe kërkesat e tregut të punës. Ky proces mbështetet në projekte kërkimore dhe bashkëpunime institucionale, si ato të realizuara në kuadër të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), të cilat kanë ndihmuar në modernizimin e kurrikulës dhe zhvillimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Gjithashtu, projektet Erasmus+ dhe bashkëpunimet me universitete

⁹³ Shtojca 1.17 – Rregullorja e Këshillit Studentor

⁹⁴ Shtojca 3.24 – Analiza vjetore Qendra e Karrierës dhe Alumni

⁹⁵ Shtojca 2.5 – Rregullorja e programit të studimit: Master i Shkencave në “Kulturë, Media dhe Editim”

institucione publike e private.	partnere kanë lehtësuar shkëmbimin e praktikave të mira ndërkombëtare dhe integrimin e metodologjive të reja në program⁹⁶. Për më tepër, krahas evidencave të paraqitura nga institucioni, gjatë vizitës atje u verifikua se departamenti zhvillon konsultime të rregullta me aktorë të industrisë dhe të diplomuarit, duke përshtatur përmbajtjen e programit me nevojat e tregut të punës. Këto përmirësime bazohen edhe në analizat e vazhdueshme të zhvillimeve rajonale dhe kombëtare. <i>Megjithatë, siç e theksuam edhe më herët në Standardin II.4, Kriteri 4, u evidentua se këto analiza janë më së shumti të fokusuara në tregun rajonal të Korçës dhe qyteteve përreth saj. Për shkak se universiteti mirëpret studentët nga e gjithë Shqipëria, rekomandojmë që në të ardhmen studimet e tregut të punës të realizohen në një nivel më të gjerë, duke reflektuar nevojat dhe kërkesat në nivel kombëtar⁹⁷.</i>			
Konkluzione	Standardi përmbushet plotësisht, pasi Universiteti "Fan S. Noli" dhe Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë kanë krijuar mekanizma efektivë për konsultimin me aktorët e tregut të punës, studentët dhe të diplomuarit, duke reflektuar kërkesat e tyre në përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Proceset e rishikimit të kurrikulës, studimet e tregut të punës dhe bashkëpunimet me institucione publike dhe private sigurojnë një përmbajtje akademike të përshtatur me zhvillimet më të fundit në fushën e kulturës, medias dhe editimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Kulturë, media dhe editim" është hartuar në përputhje me objektivat madhorë të Universitetit "Fan S. Noli" dhe Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë, duke synuar avancimin akademik dhe profesional të studentëve. Përmes Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO (Shtojca 1.3) dhe Strategjisë së Departamentit (Shtojca 2.4), janë

⁹⁶ Shtojca 2.21 – Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë

⁹⁷ Shtojca 3.13 – Studim tregu pune periodik

	përcaktuar prioritetet kërkimore, të fokusuara në politika kulturore, teknologjitë e medias dhe proceset editoriale. Rregullorja e programit dhe Manuali për punimin e diplomës (Shtojca 2.5; Shtojca 2.14) e strukturojnë kërkimin shkencor si një komponent kyç, duke integruar teori dhe praktikë. Kërkimet e studentëve dhe pedagogëve bazohen në literaturë të përditësuar dhe metodologji bashkëkohore, ndërsa të dhënat mbi kualifikimet e stafit konfirmojnë përkushtimin ndaj ekselencës akademike dhe zhvillimit të qëndrueshëm në këtë fushë⁹⁸.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të stafit dhe specifikat e fushës së studimit. Procesi mbështetet në një kuadër rregullator të qartë, i përcaktuar në Rregulloren e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (Shtojca 2.2), si dhe në Analizat vjetore të njësisë bazë (Shtojca 2.21).	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim”, nxit dhe administron në mënyrë të strukturuar veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke respektuar lirinë akademike të stafit dhe specifikat e fushës së studimit. Procesi mbështetet në një kuadër rregullator të qartë, i përcaktuar në Rregulloren e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (Shtojca 2.2), si dhe në Analizat vjetore të njësisë bazë (Shtojca 2.21). Departamenti siguron koordinimin efektiv të aktiviteteve akademike dhe kërkimore, duke përfshirë publikime shkencore, pjesëmarrje në konferenca dhe projekte kërkimore në fushën e kulturës, medias dhe editimit. Studentët inkurajohen të marrin pjesë në këto veprimtari, duke përfituar nga mundësi të integruara në studimet e tyre, e pohuar kjo prej tyre edhe gjatë vizitës sonë në institucion. Gjithashtu, programi ndjek Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO (Shtojca 1.3), i cili synon bashkëpunim ndërdisiplinor dhe përmirësimin e cilësisë akademike dhe shkencore përmes partneriteteve me institucione të tjera.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Mbështetur mbi evidencat e institucionit, por edhe vizitës atje vlerësojmë se ky program studimi nxit dhe motivon studentët për t’u angazhuar në studime dhe projekte kërkimore, duke integruar një qasje të strukturuar mbështetur në Rregulloren e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë⁹⁹. Në këtë kuadër, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë organizon konferenca, seminare dhe ëorkshope, të cilat krijojnë mundësi për përfshirjen aktive të studentëve në kërkim shkencor dhe aplikimin e njohurive teorike në praktikë.

⁹⁸ Shtojca 4. Të dhëna statistikore mbi stafin, studentët, programin e studimit. Tabela 12, 13

⁹⁹ Shtojca 2.2 – Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore Shkencore e FEF

	Sipas raportit vjetor të veprimtarisë së departamentit, një numër i konsiderueshëm studentësh janë përfshirë në projekte kërkimore dhe tema diplomash të lidhura me prioritetet akademike dhe kërkesat e tregut të punës¹⁰⁰. Gjithashtu, bashkëpunimet me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë projektet e financuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), kanë forcuar ndërlidhjen e programit me zhvillimet e reja në fushën e kulturës dhe medias. Studentët e intervistuar gjatë vizitës sonë në institucion konfirmuan përfshirjen e tyre në aktivitete kërkimore dhe vlerësuan mbështetjen e stafit akademik në procesin e mentorimit dhe hartimit të diplomave. Për më tepër, ofrimi i udhëzuesve për hartimin e punimeve shkencore dhe aksesimi i burimeve akademike përmes bibliotekës dhe platformave digjitale, rezultoi se ka lehtësuar zhvillimin e projekteve kërkimore, duke ndihmuar studentët të fitojnë kompetenca të thelluara shkencore dhe profesionale.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Financimi i veprimtarive studimore, kërkimore dhe shkencore për programin “Master i Shkencave” në “Kulturë, Media dhe Editim” mbështetet nga Universiteti “Fan S. Noli” dhe Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, në përputhje me Statutin e Universitetit dhe Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO. Burimet financiare përfshijnë fonde institucionale dhe projekte të mbështetura nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), si dhe programet e mobilitetit Erasmus+. Sipas analizës vjetore të veprimtarisë së njësisë bazë¹⁰¹, projektet kërkimore si “Themeluesit e Komedisë Shqipe” dhe “Ballkani në rrënjët e studimeve gjuhësore, letrare, historike dhe etnografike” kanë ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin akademik të studentëve dhe promovimin e kërkimit shkencor. Ky sistem i integruar garanton që mbështetja financiare të kontribuojë në përmbushjen e objektivave akademike dhe kërkimore të programit.
Konkluzione	<i>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” garanton orientimin e studentëve në kërkimin shkencor përmes një strukture të qartë akademike, mbështetjes institucionale dhe integritetit të veprimtarive kërkimore në kurrikul. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë ka krijuar mekanizma efektivë për nxitjen e kërkimit shkencor, përfshirjen e studentëve në projekte akademike</i>

¹⁰⁰ Shtojca 2.21 – Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë (Departamentit)

¹⁰¹ Shtojca 2.21 – Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë (Departamentit)

	<i>dhe bashkëpunimin me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Financimi i siguruar nga burime institucionale dhe projekte të jashtme ka ndihmuar në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarive studimore dhe shkencore. Për këto arsye, standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë mbështet në mënyrë aktive zhvillimin e kërkimit shkencor dhe projekteve të reja studimore, duke siguruar bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore dhe duke përfshirë stafin akademik dhe studentët në aktivitete kërkimore. Këto përpjekje reflektohen në organizimin e projekteve të financuara, studimeve akademike dhe integrimin e temave të diplomave me kërkesat bashkëkohore të fushës ¹⁰² . Përmes marrëveshjeve ndërkombëtare, si mobilitetet Erasmus+, departamenti ka zgjeruar rrjetet e tij akademike dhe ka integruar praktika të mira kërkimore në kurrikulën e programit ¹⁰³ . Gjithashtu, bashkëpunimi me institucione të tjera kërkimore dhe projekte të përbashkëta kanë mundësuar ndërlidhjen e kërkimit shkencor me nevojat e tregut të punës, duke forcuar komponentin akademik dhe praktik të programit të studimit.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë rezulton se ka një angazhim të vazhdueshëm në realizimin e studimeve dhe projekteve kërkimore, duke përfshirë si personelin akademik ashtu edhe studentët. Ky përkushtim reflektohet në pjesëmarrjen aktive të stafit në publikime shkencore ¹⁰⁴ dhe në projekte të rëndësishme kërkimore, si "Themeluesit e komedisë shqipe", një projekt i financuar nga AKKSHI, dhe "Ballkani në rrënjët e studimeve gjuhësore, letrare, historike dhe etnografike", që synon hulumtimin e trashëgimisë kulturore rajonale.

¹⁰² Shtojca 2.14 – Udhëzues i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë për punimin e diplomës

¹⁰³ Shtojca 2.4 – Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë

¹⁰⁴ Shtojca 3.2.2 – Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore

	Në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, departamenti promovon përfshirjen e studentëve në veprimtari kërkimore, siç dëshmohet nga perurimi i antologjisë së punimeve shkencore të studentëve¹⁰⁵. Po ashtu, pjesëmarrja në mobilitete ndërkombëtare Erasmus+ dhe projekte si LEA4School ka ndihmuar në forcimin e lidhjeve kërkimore me institucione ndërkombëtare. Ky angazhim institucional garanton një qasje të strukturuar ndaj kërkimit shkencor dhe krijon mundësi të gjera për përfshirjen e studentëve dhe stafit në projekte me ndikim akademik dhe profesional.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në lidhje me këtë kriter, vlerësojmë se Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë ka organizuar një sërë konferencash, ëorkshopesh dhe aktivitete kërkimore, të cilat ndihmojnë në zhvillimin akademik dhe profesional të personelit dhe studentëve. P.sh., Konferenca “Albanologjia, Trashëgimia Kulturore dhe Kërkimi Shkencor” (29 shtator 2023) dhe “Letërsitë Kombëtare në Sistemin Universitar” (nëntor 2023) rezultojnë se kanë trajtuar çështje kyçe të kulturës dhe letërsisë, duke krijuar hapësira për debat akademik dhe hulumtim shkencor. Nga ana tjetër, edhe studentët janë përfshirë në mënyrë aktive në kërkimin shkencor, siç dëshmohet nga perurimi i antologjisë “Kërkimi Shkencor në Letërsi” (prill 2024), e cila përmbledh punime të mentoruara nga pedagogët. Po ashtu, ëorkshopi “Media dhe Ligjërimi Publik” (nëntor 2023) ka kontribuar në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve në komunikim dhe analizë mediatike. Përveç këtyre, projekti kërkimor “Themeluesit e Komedisë Shqipe”, i financuar nga AKKSHI, ka integruar personelin akademik dhe studentët në një proces shkencor që lidhet me studimin dhe ribotimin e veprave letrare me aparat kritik¹⁰⁶. Këto aktivitete dëshmojnë angazhimin e departamentit për të ndërtuar një kulturë kërkimore të fortë dhe për të rritur ndërveprimin midis teorisë dhe praktikës.
Kriteri 4. Programi i studimit formon	Programi i studimit “Master i Shkencave në Kulturë, Media dhe Editim” është i strukturuar për të përgatitur profesionistë

¹⁰⁵ Shtojca 3.6 – Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit

¹⁰⁶ Shtojca 3.2.2 – Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore

profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Plani mësimor përfshin module të avancuara që ndërthurin teorinë me praktikën dhe adresojnë kërkesat e tregut¹⁰⁷. Bashkëpunimet me institucione dhe organizata profesionale kanë mundësuar praktika dhe eksperiencë pune për studentët, duke lehtësuar integrimin e tyre në tregun e punës¹⁰⁸. Gjithashtu, analizat periodike të tregut të punës sigurojnë që programi të jetë i përditësuar me zhvillimet më të fundit në kulturë, media dhe editim, duke integruar tendencat teknologjike dhe kërkesat e Listës Kombëtare të Profesioneve¹⁰⁹. Vlerësojmë si pozitive përfshirjen e stafit akademik në projekte dhe publikime ndërkombëtare, gjë që ndihmon në rritjen e cilësisë së programit dhe në përgatitjen e studentëve për karriera kërkimore dhe profesionale¹¹⁰.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive</i> , 2005/36/EU).	Nuk aplikohet për këtë program studimi.
Konkluzione	<i>Programi i studimit siguron një bazë të fortë akademike dhe profesionale, duke mbështetur zhvillimin e kërkimit shkencor,</i>

¹⁰⁷ Shtojca 2.7 – Plani mësimor i programit të studimit

¹⁰⁸ Shtojca 2.15 – Udhëzues i DGL mbi praktikën mësimore/institucionale

¹⁰⁹ Shtojca 3.13 – Studim tregu pune periodik

¹¹⁰ Shtojca 3.6 – Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit

	organizimin e konferencave dhe aktiviteve shkencore, si dhe përgatitjen e studentëve për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Njësia bazë ka ndërtuar një kornizë të qëndrueshme bashkëpunimi me institucione kërkimore dhe profesionale, duke garantuar integritetin e studentëve dhe stafit akademik në projekte shkencore dhe rrjete ndërkombëtare. Nëpërmjet strukturës së kurrikulës, praktikave profesionale dhe studimeve të tregut të punës, programi formon specialistë të aftë për të konkurruar në fushat e kulturës, medias dhe editimit. Rrjedhimisht, standardi përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Po, referuar rregullores së organizimit të verpimtarisë mësimore-kërkimore shkencore të FEF, Planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve, konstatohet se objektivat formuese dhe kompetencat profesionale të programit synohen të arrihen nëpërmjet veprimtarive formuese dhe përbërësve mësimorë që karakterizojnë këtë program studimi. Kryesisht ato janë: - Mësim në auditor, si leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale; - Studim individual, si studim e punim relacionesh, detyra apo projekte; - Përgatitje për provime; - Përgatitje e tezës së diplomës;

	- Veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private¹¹¹. Nga ana tjetër, ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë përcaktohen në planin mësimor, me kreditë të caktuara për çdo disiplinë.¹¹² Kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë programin e studimit janë të parashikuara edhe në Rregulloren e studimit të FEF.¹¹³ Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet instrumenteve të vlerësimit si testimet me shkrim dhe me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, praktikave dhe tezave të diplomës. Metodat e vlerësimit janë strategjitë, teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën studenti demonstroi përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit.¹¹⁴ Element i rëndësishëm i thellimit të njohurive teorike profesionale është ndërthurja e teorisë me praktikën, ku studentët, në përfundim të semestrit IV realizojnë praktikën institucionale me ngarkesë mësimore 6 ECTS /150 orë (punë individuale, në kompani dhe takime me mbikqyrësin, mentorin e praktikës).¹¹⁵
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Siç e theksuam edhe në kriterin pararendës, personeli akademik aplikon një sërë metodash bashkëkohore të mësimdhënies, në përgjigje të nevojave për një proces mësimor sa më efektiv për studentët. E gjithë kjo veprimtari e ndjekur nga personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, parashikohet në Rregulloren e FEF¹¹⁶. Bazuar në evidencat e institucionit dhe në të dhënat e mbledhura gjatë takimit me anëtarët e personelit akademik, por edhe me studentët në institucion, u vu re se ky proces karakterizohet nga një përdorim i alternuar i formave të mësimdhënies, në varësi të

¹¹¹ Shtojca 2.2. - Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF, Neni 72.

¹¹² Shtojca 2.7. - Plani Mësimor i Programit të studimit

¹¹³ Shtojca 2.2. Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF, Neni 73 .

¹¹⁴ Shtojca 1.2. Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO, Neni 63 ; Neni 64.

¹¹⁵ Shtojca 2.7. - Plani Mësimor i Programit të studimit

¹¹⁶ Shtojca 2.2. Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF, Neni 23 .

	lëndës/modulit, me ilustrime audio-vizuale, zbatime në terren dhe institucione. Pedagogët angazhojnë studentët në punë në grup për realizimin e projekteve të kursit dhe projekteve institucionale, duke i ndihmuar të zhvillojnë aftësi bashkëpunimi dhe shkëmbimi idesh. Gjithashtu, studentët përfshihen në veprimtari shkencore të organizuara nga institucioni, duke i ekspozuar ndaj një procesi mësimor më dinamik dhe praktik. Përveç kësaj, departamenti organizon aktivitete me karakter formues kulturor, ku studentët marrin pjesë aktivisht për të arritur objektivat formuese dhe rezultatet e pritshme të programit.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Po, vlerësojmë se UNIKO ka një sërë aktivitete të dokumentuara që mbështesin përmirësimin e kompetencave didaktike të stafit akademik. Kjo konfirmohet edhe nga personeli akademik gjatë takimeve tona në institucion. Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, pedagogët marrin pjesë në trajnime dhe shkëmbime akademike, duke përfutur nga praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe duke i zbatuar ato në auditore. Programet si Erasmus+ dhe partneritetet me universitete evropiane, si Universiteti Ovidius i Rumanisë dhe Universiteti i Orleanit në Francë, kanë lehtësuar mobilitetin akademik dhe përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies. Gjithashtu, organizimi i trajnimeve mbi edukimin mediatik dhe inteligjencën artificiale në arsim ka ndihmuar pedagogët të përditësojnë aftësitë e tyre në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.	Bazuar në evidencat e institucionit, vlerësojmë se stafi akademik i përfshirë në mësimdhënien e programit “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” është i kualifikuar dhe demonstroi kompetencë në shpjegimin e koncepteve, përdorimin e metodave interaktive dhe nxitjen e mendimit kritik te studentët. Procedurat e rekrutimit bazohen në kritere të qarta, të përcaktuara në Manualin e Cilësisë të UNIKO¹¹⁷ dhe Rregulloren e Universitetit “Fan S. Noli”¹¹⁸, duke garantuar përzgjedhjen e stafit me kualifikime të larta dhe përvojë akademike. Mbi 50% e pedagogëve janë profesorë me trajnime dhe eksperiencë në

¹¹⁷ Shtojca 1.16. Manuali i Cilësisë së UNIKO

¹¹⁸ Shtojca 1.2. Rregullorja e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO

Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	universitete ndërkombëtare¹¹⁹, çka përmirëson cilësinë e mësimdhënies dhe integrimin e praktikave më të mira evropiane. Metodat e mësimdhënies janë të orientuara drejt studentit dhe përfshijnë seminare, ëorkshop-e dhe përdorimin e pajisjeve audiovizuale për të rritur ndërveprimin¹²⁰. Studentët angazhohen në aktivitete akademike dhe trajnohen nga specialistë të fushës, duke siguruar një përvojë të plotë profesionale dhe akademike.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga verifikimet e bëra përmes evidencave dhe vizitës së zhvilluar në institucion, mund të themi se Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë realizon një proces të rregullt vlerësimi dhe përmirësimi të metodave të mësimdhënies, duke përfshirë stafin akademik dhe studentët në këtë proces. Ky vlerësim mbështetet në Analizën Vjetore të Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore¹²¹ dhe në rishikimin periodik të programit të studimit¹²², ku analizohen mjetet didaktike dhe sfidat në mësimdhënie. Një element kyç i këtij procesi është angazhimi i studentëve përmes pyetësorëve të ndryshëm, të cilët vlerësojnë efektivitetin e metodave të mësimdhënies dhe japin sugjerime për përmirësime¹²³. Vlerësimet dhe rekomandimet e tyre përpunohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimet e bëra çdo vit¹²⁴. Për më tepër, universiteti organizon trajnime të rregullta për stafin akademik në bashkëpunim me AKKSHI, Zyrën Erasmus+ dhe projekte ndërkombëtare, duke integruar metoda të reja mësimore dhe përmirësuar cilësinë e procesit mësimor. Ky sistem gjithëpërfshirës i vlerësimit dhe përmirësimit garanton që programi i studimit të ruajë cilësinë akademike dhe të përmbushë nevojat e studentëve dhe të tregut të punës.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të	Universiteti “Fan S. Noli” ka ngritur dhe vënë në funksion struktura të qarta organizative për koordinimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Drejtoria e Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe fakultetet, mbështet

¹¹⁹ Shtojca 3.9. Tabela e kualifikimeve të stafit akademik

¹²⁰ Shtojca 2.7. Plan i mësimor i programit të studimit

¹²¹ Shtojca 2.20. Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore FEF

¹²² Shtojca 2.12. Procedura e ndryshimeve në planin mësimor (rishikimi i kurrikulës)

¹²³ Shtojca 3.14. Pyetësorët studentorë

¹²⁴ Shtojca 3.7. Raportet vjetore të NJSBC

mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies¹²⁵. Këto struktura angazhohen në vlerësimin periodik të performancës akademike, koordinimin e rishikimeve të kurrikulave dhe implementimin e strategjive për mësimdhënien inovative¹²⁶. Gjithashtu, institucioni ka organizuar trajnime të vazhdueshme për stafin akademik, duke përfshirë ëorkshope, leksione të hapura dhe projekte ndërkombëtare, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, si p.sh. trajnimi dy ditor i zhvilluar nga Universiteti “Fan S. Noli” në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Medias. Përmes pjesëmarrjes në projekte si Erasmus+ dhe mobilitete akademike, pedagogët marrin përvoja nga universitete ndërkombëtare dhe zbatojnë praktikën më të mira në auditorë. I tillë rezultoi të jetë ai i trajnimeve për stafin akademik në kuadër të projektit Bologna Hub Peer Support. Nga ana tjetër, përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie rezultoi se është përmirësuar, duke integruar mjetet dixhitale dhe platformat e e-learning në procesin akademik¹²⁷. Për më tepër, vlerësimet e studentëve për metodat e mësimdhënies përmes pyetësorëve periodikë ndikojnë në përmirësimet e nevojshme të programeve¹²⁸. <i>Por, gjatë vizitës në institucion, në disa raste u vu re se ka një zbatim të pabarabartë i praktikave të reja pedagogjike. Ndërsa parimet inovative janë të pranishme në politikat institucionale, ato nuk zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha komponentët e programit të studimit.</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara, standardi III.1 përmbushet plotësisht. Institucioni garanton një proces të mirëstrukturuar të të nxënës, duke kombinuar metodat tradicionale dhe inovative të mësimdhënies, me një theks të veçantë në ndërthurjen e teorisë me praktikën. Personeli akademik është i kualifikuar dhe përdor strategji të ndryshme pedagogjike, duke iu përshtatur nevojave të studentëve dhe duke nxitur mendimin kritik e krijues. Universiteti mbështet vazhdimisht stafin në përmirësimin e kompetencave didaktike përmes trajnimeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare. Për më tepër, vlerësimi periodik i metodave të</i>

¹²⁵ Shtojca 1.5. Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional

¹²⁶ Shtojca 1.16. Manuali i Cilësisë së UNIKO

¹²⁷ Shtojca 2.21. Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë (departamentit)

¹²⁸ Shtojca 3.14. Pyetësorët studentorë

	<i>mësimdhënies dhe përfshirja e studentëve në këtë proces siguron një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit “Fan S. Noli”¹²⁹ dhe Rregulloren e Programit të Studimit: Master i Shkencave në “Kulturë, Media, Editim” (Shtojca 2.5). Këto dokumente përshkruajnë qartë format e mësimdhënies dhe sistemin e vlerësimit, duke siguruar transparencë dhe parashikueshmëri për studentët. Vlerësimi i studentëve realizohet në një shkallë prej 10 notash, ku nota kaluese më e ulët është 5 (pesë) dhe nota më e lartë 10 (dhjetë). Për provimet me shkrim dhe me gojë, përdoret një sistem me pikë, i cili konvertohet në nota sipas një skeme të qartë. Gjithashtu, vlerësimi përfundimtar i studentit përfshin vlerësimin e vazhdueshëm (maksimumi 30 pikë) dhe provimin përfundimtar (maksimumi 70 pikë)¹³⁰. Studentët informohen për metodologjinë e vlerësimit që në fillim të semestrit përmes syllabuseve të lëndëve, të cilat janë të publikuara nga pedagogët dhe prezantohen gjatë orëve të para të zhvillimit të modulit përkatës. Ky sistem garanton transparencë, qartësi dhe një proces të drejtë të vlerësimit për të gjithë studentët.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Studentët informohen në mënyrë të qartë dhe të strukturuar për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive që në fillim të çdo lënde/moduli. Gjatë orës së parë të mësimdhënies, pedagogu prezanton strukturën e lëndës, mënyrën e vlerësimit dhe literaturën e nevojshme, duke specifikuar përqindjen e secilit komponent vlerësues (kolokiume, seminare, projekte kursi, kuize, detyra kursi, etj.). Ky informacion është gjithashtu i publikuar në

¹²⁹ Shtojca 1.2. Kreu VII

¹³⁰ Shtojca 2.2. Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mesimore Kërkimore Shkencore e FEF, Kreu VI

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	syllabuset e lëndëve dhe i aksesueshëm në mënyrë të vazhdueshme në platformën digjitale PITAGORA ¹³¹ , të cilën UNIKO ka në funksion përmes një marrëveshjeje me RASH ¹³² . Për më tepër, studentët e viteve të para marrin informacion të përgjithshëm mbi programin e studimit që në ditën e parë të vitit akademik, duke siguruar një proces transparent dhe të qartë të vlerësimit ¹³³ .			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive në “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” është i qartë dhe i strukturuar, duke u bazuar në rregulloret institucionale dhe programin lëndor të secilit modul ^{134,135,136,137} . Studentët vlerësohen përmes formave të ndryshme, duke përfshirë testimet e ndërmjetme, aktivizimin në seminare, realizimin e projekteve dhe provimin final. Provimi final mund të jetë me shkrim, me gojë ose i kombinuar, në varësi të modulit dhe përcaktimeve të pedagogut. Format e vlerësimit specifikohen në syllabusin e secilës lëndë dhe komunikohen studentëve që në fillim të procesit mësimor ^{138,139} , duke siguruar transparencë dhe vlerësim të plotë të kompetencave të fituara nga studentët.			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve për këtë standard, vlerësojmë se institucioni ka rregullore dhe procedura të qarta për testimin dhe vlerësimin e njohurive, të cilat janë të dokumentuara dhe publikohen për studentët. Procesi i vlerësimit është i strukturuar dhe transparent, duke siguruar informimin e studentëve që në fillim të çdo lënde për metodologjinë e testimit dhe mënyrat e vlerësimit. Diversiteti i formave të vlerësimit – përmes testimeve, projekteve, seminareve dhe provimeve përfundimtare – u mundëson studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara. Këto elemente tregojnë se standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹³¹ Shtojca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA

¹³² Shtojca 1.6. Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora

¹³³ Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, Kreu VII

¹³⁴ Shtojca 1.2. Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, Kreu VII

¹³⁵ Shtojca 2.2. Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF, Kreu VI

¹³⁶ Shtojca 2.5. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Kulturë, Media, Editim”

¹³⁷ Shtojca 2.8. Model Programi Lendor (Syllabus) në Programin e Studimit Master i Shkencave në “Kulturë, Media, Editim”

¹³⁸ Shtojca 2.5. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Kulturë, Media, Editim”

¹³⁹ Shtojca 2.2. Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF, Kreu VI

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Institucioni ka përcaktuar procedura të qarta për testimin dhe vlerësimin e njohurive gjatë gjithë vitit akademik, të cilat reflektohen në vlerësimin përfundimtar të studentëve. Këto janë të pasqyruara në syllabuset e lëndëve, në rregulloret institucionale dhe në rregulloret e njësive akademike përkatëse. Struktura e vlerësimit parashikon përdorimin e formave të ndryshme të testimit, si kolokuiumet, projektet e kursit, detyrat, seminarët dhe provimi përfundimtar. Kjo siguron që studentët të vlerësohen jo vetëm në bazë të një provimi përfundimtar, por përmes një procesi të vazhdueshëm, gjë që përputhet me praktikat më të mira akademike.¹⁴⁰ Pesha e vlerësimit të komponentëve të ndryshëm përcaktohet në syllabus dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit, duke mundësuar transparencë në procesin e vlerësimit¹⁴¹. Provimet finale zhvillohen me shkrim, me gojë ose në format të kombinuar, bazuar në vendimmarrjen e pedagogut dhe sipas programit lëndor. Kjo fleksibilitet siguron që metodat e vlerësimit të jenë në përputhje me natyrën e lëndëve dhe objektivat akademike. Sistemi i vlerësimit me pikë është i përcaktuar qartë dhe reflektohet në notat përfundimtare, duke siguruar një sistem të standardizuar të vlerësimit për të gjithë studentët¹⁴².
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme	Institucioni ka vënë në zbatim sisteme elektronike për testimin dhe vlerësimin, duke përmirësuar transparencën dhe saktësinë e procesit të vlerësimit.

¹⁴⁰ Shtojca 2.8. Model Programi lëndor (Syllabus) në Programin e Studimit Master i Shkencave në "Kulturë, Media, Editim"

¹⁴¹ Shtojca 2.2. Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, Neni 80

¹⁴² Shtojca 1.2. Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Neni 84

abuzimi dhe rrisin transparencën.	Platforma CleanScore, e implementuar përmes një marrëveshjeje me Fondin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit ¹⁴³ , lejon korrigjimin e automatizuar të provimeve, duke shmangur subjektivitetin dhe duke rritur besueshmërinë në procesin e vlerësimit. Sistemi ndihmon gjithashtu në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke integruar tekste akademike të përditësuara me standardet ndërkombëtare.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i studentëve në “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” kryhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi, duke siguruar një proces të qartë dhe të standardizuar. Modalitetet e vlerësimit, metodat e testimit dhe detyrimet e studentëve përcaktohen qartë në syllabus dhe bëhen të njohura për studentët që në fillim të semestrit ¹⁴⁴ . Institucioni përdoret sistemin shqiptar të vlerësimit me 10 nota, me nota kaluese nga 5 deri në 10 ¹⁴⁵ . Vlerësimi përfshin testime të ndërmjetme, detyra kontrolli dhe provimin final, i cili mund të zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar ¹⁴⁶ .
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Procesi i vlerësimit në “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim” përfshin komente dhe feedback për studentët, duke i ndihmuar ata të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. Gjatë testimeve, detyrave të kursit dhe provimeve, personeli akademik ofron komente të dokumentuara në fletoret e provimeve me shkrim ose feedback verbal në provimet me gojë ¹⁴⁷ . Rezultatet e provimeve shpallen dhe hidhen në sistem brenda 2 ditëve për provimet me gojë dhe brenda 6 ditëve për provimet me shkrim. Studentët kanë të drejtë të kërkojnë sqarime ose të ankimojnë vlerësimin, duke garantuar një proces transparent dhe të drejtë.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Institucioni ka vendosur masa të qarta për të shmangur plagjiaturën dhe kopjimin gjatë provimeve dhe detyrave të kursit, duke garantuar integritetin akademik. Për çdo provim, komisioni përbëhet nga të paktën dy anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës, dhe emërimi i tyre bëhet nga përgjegjësi i departamentit

¹⁴³ (Shtojca 3.19. Marrëveshje për provimet e automatizuara me CleanScore

¹⁴⁴ Shtojca 2.8. Model Programi Lendor (Syllabus)

¹⁴⁵ Shtojca 2.2. Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore-Kërkimore Shkencore e FEF, Neni 91

¹⁴⁶ Shtojca 2.2, Neni 83-85

¹⁴⁷ Shtojca 2.2, Neni 92

	në bashkëpunim me zëvendësrektorin për mësimin¹⁴⁸. Për të siguruar korrektësinë e procesit, studentët nuk lejohen të hyjnë në provim pa një dokument identifikimi ose një vërtetim nga sekretaria mësimore, ndërsa anëtarët e komisionit mbikëqyrin në mënyrë rigoroze zhvillimin e provimit nga fillimi deri në fund.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rregullorja e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF, ka përcaktuar një sistem të detajuar për vlerësimin e studentëve, i cili ndahet në vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin përfundimtar, duke siguruar që të gjitha format e kontrollit të dijeve janë të bazuara në meritë dhe të reflektojnë përvetësimin e njohurive të studentëve¹⁴⁹. Gjatë vitit akademik, studentët vlerësohen përmes testeve të ndërmjetme, detyrave të kursit dhe projekteve, të cilat janë të përcaktuara në syllabus dhe ndikojnë në notën përfundimtare. Provimi final mund të zhvillohet me shkrim, me gojë ose në mënyrë të kombinuar, në përputhje me natyrën e modulit dhe rregullat institucionale. Për të garantuar transparencë dhe respektimin e afateve, rezultatet regjistrohen në sistem brenda dy ditëve për provimet me gojë dhe tetë ditëve kalendarike për provimet me shkrim¹⁵⁰. Nëse ka vonesa në publikimin e rezultateve, anëtarët e komisionit mbajnë përgjegjësi administrative. Studentët kanë të drejtën e ankimit për vlerësimin e marrë, duke kërkuar një rishikim brenda afateve të përcaktuara. Komisioni i provimit ka detyrimin të sqarojë studentët, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara me tezat e korrigjuara, përpara se vlerësimi të bëhet përfundimtar¹⁵¹. Ky sistem siguron që vlerësimi të jetë objektiv, meritokratik dhe i bazuar në transparencë, duke garantuar një proces të drejtë për të gjithë studentët.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në	UNIKO garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim të tij brenda afateve të përcaktuara. Pas shpalljes së rezultateve dhe hedhjes së tyre në sistem, studentët kanë mundësinë të sqarohen mbi vlerësimin e tyre ose të kundërshtojnë rezultatin e marrë. Komisioni i provimit është i detyruar të ballafaqojë përgjigjet e dokumentuara të

¹⁴⁸ Shtojca 2.2, Neni 88; 89

¹⁴⁹ Shtojca 2.2, Neni 83; 77

¹⁵⁰ Shtojca 2.2, Neni 86

¹⁵¹ Shtojca 2.2, Neni 89, 90

statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	studentit me tezat e korrigjuara përpara se nota të konsiderohet përfundimtare. Afati maksimal për rishikimin e notës është 12 ditë nga dita e provimit, pas së cilës sistemi mbyllet dhe nuk mund të bëhen ndryshime ^{152,153} . Ky mekanizëm siguron transparencë dhe drejtësi në vlerësimin akademik të studentëve.			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nga verifikimet e bëra, rezulton se institucioni ka përcaktuar një procedurë të qartë dhe të dokumentuar për shqyrtimin e ankesave dhe ankimeve të studentëve në lidhje me vlerësimin akademik. Studentët kanë të drejtën të ankimeve në rastet kur konsiderojnë se janë shkelur rregullat procedurale të provimit ose nuk janë dakord me vlerësimin e marrë. Ankesa ëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit ose brenda 48 orëve pas shpalljes së rezultatit dhe i drejtohet dekanit të fakultetit. Dekani shqyrton ankesën dhe mund të thërrasë për sqarime përfaqësues të departamentit përkatës, anëtarët e komisionit të provimit, si dhe vetë studentin. Nëse ankesa vlerësohet e drejtë, dekan mund të vendosë që studenti të rijapë provimin me një komision të ri brenda një afati të përcaktuar. Vendimi i dekanit është përfundimtar dhe i formës së prerë ^{154,155} . Kjo procedurë synon garantimin e transparencës dhe drejtësisë në trajtimin e ankesave të studentëve.			
Konkluzione	<i>Mbështetur në analizën e dokumentacionit dhe procedurave të raportuara nga institucioni, vlerësohet se standardi për vlerësimin e drejtë dhe transparent të studentëve përmbushet plotësisht. Institucioni ka përcaktuar rregullore të detajuara për procesin e vlerësimit, duke përfshirë testimin gjatë gjithë vitit akademik, përdorimin e sistemit elektronik të vlerësimit, mundësinë e studentëve për të marrë feedback mbi performancën e tyre dhe mekanizmat e ankimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

¹⁵² Shtojca 1.2. Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mesimore dhe kerkimore e UNIKO, Neni 82, 83

¹⁵³ Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mesimore Kerkimore Shkencore e FEF, Neni 89, 90

¹⁵⁴ Shtojca 1.2. Rregullore e Universitetit Fan S. Noli, Neni 83

¹⁵⁵ Shtojca 2.2. Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore-Kërkimore Shkencore FEF, Neni 90

Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, përfshirë Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Kulturë, Media, Editim”¹⁵⁶, konstatohet se programi ka objektiva të qarta që synojnë thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve. Struktura e kurrikulës, me një ngarkesë prej 120 kreditesh gjatë dy viteve akademike, është ndërtuar për të pajisur studentët me njohuri të avancuara në kontekstin historik, institucional dhe social të kulturës dhe medias, si dhe me aftësi të thelluara në teknologjitë dhe dizajnin e botimeve. Gjithashtu, metodologjitë e mësimdhënies dhe format e ndryshme të mësimit të zbatuara në program krijojnë mundësi për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe analitike. Përmes lëndëve specifike, studentët mësojnë të përdorin metoda të avancuara kërkimi dhe strategji inovative për prodhimin e përmbajtjes mediatike dhe kulturore, duke i lidhur këto njohuri me aplikime praktike në zhvillimin e projekteve të kulturës dhe medias, promovimin e vlerave kulturore dhe zhvillimin e turizmit¹⁵⁷. Nga analiza e përmbajtjes së programit dhe kompetencave të synuara, vlerësojmë se programi është ndërtuar në përputhje me kërkesat akademike të një Masteri Shkencor, duke siguruar një nivel të avancuar të formimit akademik dhe profesional për studentët e këtij profili.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Referuar evidencave të paraqitura nga institucioni^{158,159} konstatohet se programi i studimit është konceptuar për të garantuar zhvillimin e aftësive të veçanta në teknologjinë e informacionit, shkencat humane dhe sociale, komunikimin dhe ndërveprimin kulturor. Lëndët e përfshira në planin mësimor, si Gjuha në komunikimet publike, Komunikimi ndërkulturor, Media dhe kultura, Dizajni dhe faqosja, Media sociale dhe Sociologjia e kulturës, mbështesin përvetësimin e aftësive praktike dhe akademike të nevojshme për sektorët e kulturës, medias dhe botimeve. Këto lëndë ofrojnë studentëve njohuri të avancuara për strategjitë e promovimit kulturor dhe përdorimin e teknologjisë në komunikim dhe botime.

¹⁵⁶ Shtojca 2.5. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Kulturë, Media, Editim”

¹⁵⁷ Shtojca 2.7. Plan i Mësimor i Programit të studimit

¹⁵⁸ Shtojca 2.8. Programet lëndore të programit të studimit

¹⁵⁹ Shtojca 2.5. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Kulturë, Media, Editim”

	Në veçanti, programi i studimit synon të zhvillojë tek studentët aftësitë për: - Zbatimin e njohurive teknologjike në përpunimin dhe publikimin e materialeve në media dhe kulturë; - Përdorimin e mjeteve dixhitale për krijimin e përmbajtjes dhe promovimin e vlerave kulturore në nivel lokal dhe ndërkombëtar; - Përdorimin e terminologjisë së fushës në gjuhë të huaj, duke ndihmuar në ndërveprimin profesional në një kontekst global¹⁶⁰. Nga sa më sipër, vlerësojmë se programi adreson në mënyrë të qartë kërkesat e kriterit, duke integruar elementë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, aftësitë sociale dhe ndërveprimin ndërkulturor në një kurrikul të strukturuar.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Kulturë, Media, Editim”, institucioni ka përcaktuar mekanizma për analizimin dhe shqyrtimin e kompetencave dhe aftësive të studentëve në përfundim të çdo lënde. Kjo rregullore parashikon që personeli akademik të vërë në dukje çështjet kryesore të lëndës, të orientojë studentët në zbatimin e tyre dhe të sigurojë përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse. Gjithashtu, formulari i vlerësimit të fund kursit¹⁶¹ shërben si një instrument për mbledhjen e opinioneve të studentëve mbi përmbajtjen dhe cilësinë e lëndëve, duke ndihmuar në identifikimin e fushave për përmirësim. Për më tepër, rishikimi periodik i programit realizohet përmes Komisionit ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit¹⁶², i cili synon të përshtatë programin me nevojat akademike dhe kërkesat e tregut të punës.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në terren, konstatohet se programi i studimit Master i Shkencave në “Kulturë, Media, Editim” integron elementë të rëndësishëm për zhvillimin e kompetencave praktike të studentëve. Kjo realizohet përmes kombinimit të metodave të ndryshme të mësimdhënies, punës në

¹⁶⁰ Shtojca 2.8. Programet lëndore të programit të studimit

¹⁶¹ Shtojca 3.18. Model formulari fund kursi

¹⁶² Shtojca 3.23. Dokument për ngritjen e grupit ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit

akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	grup dhe diskutimeve akademike, si dhe përfshirjes së praktikave profesionale në institucione të ndryshme publike dhe private¹⁶³. Institucioni ka bërë përpjekje për të lidhur programin me kërkesat e tregut të punës, duke u bazuar në Lista Kombëtare e Profesioneve, e cila përfshin profilet profesionale për të cilat programi synon të përgatisë studentët. Në këtë kuadër, përfshirja e praktikave profesionale luan një rol kyç, duke i lejuar studentët të aplikojnë njohuritë teorike në një mjedis pune të vërtetë. Për më tepër, vlerësimi i praktikës nga institucionet ku studentët kryejnë eksperiencën profesionale, i cili përfshin edhe pyetjen nëse do të punësonin praktikantin nëse do të kishin vende të lira, përfaqëson një mekanizëm të dobishëm për reflektimin mbi cilësinë dhe përshtatshmërinë e programit¹⁶⁴. Gjithashtu, zhvillimi i “Tryezave të debatit” me përfaqësues të industrisë dhe institucioneve partnere është një iniciativë e dobishme për të afruar studentët me realitetet e tregut të punës dhe për të orientuar përmirësimet e mëtejshme të programit. Në aspektin e metodave të mësimdhënies, përfshirja e detyrave të kursit, projekteve dhe analizës së rasteve studimore ndihmon në zhvillimin e aftësive analitike dhe hulumtuese të studentëve.
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Po, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe informacionin e marrë gjatë vizitës institucionale, vlerësojmë se stafi akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura mbi zhvillimet më të fundit në shkencë dhe teknologji. Këto aktivitete organizohen si pjesë e kërkimit shkencor të pedagogëve dhe përfshijnë edhe bashkëpunime me specialistë të fushës. Studentët inkurajohen të marrin pjesë aktive në këto iniciativa, si në formën e trajnimeve apo projekteve të lidhura me lëndët/modulet e programit. Ky angazhim kontribuon në përditësimin e njohurive dhe rritjen e ndërveprimit akademik mes pedagogëve dhe studentëve.
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës, konstatohet se Universiteti “Fan S. Noli” ka një strategji të qartë për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe nxitjen e inovacionit në nivel akademik. Plani

¹⁶³ Shtojca 2.10. Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave profesionale

¹⁶⁴ Shtojca 2.15. Udhëzuesi i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë mbi praktikën mësimore/institucionale.

Formular 1 - për vlerësimin e programit të praktikës nga institucioni ku kryhet praktika

kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	strategjik i institucionit thekson rolin e kërkimit shkencor si pjesë integrale e cilësisë së mësimdhënies dhe promovimit të stafit akademik¹⁶⁵. Institucioni ka ndërmarrë hapa për të nxitur përfshirjen e studentëve të ciklit të dytë në projekte kërkimore, si dhe për të ofruar mbështetje financiare për publikimet në revista me faktor impakti¹⁶⁶. Gjithashtu, bashkëpunimi mes stafit akademik dhe studentëve në projekte të përbashkëta kërkimore është një praktikë që synohet të përforcohet më tej përmes politikave institucionale.			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e dokumentacionit dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës, konstatohet se Universiteti "Fan S. Noli" ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përmbushur kriteret e vlerësuar, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e kompetencave të studentëve, përfshirjen e tyre në kërkimin shkencor dhe mbështetjen financiare të inovacionit. Struktura e programit, rishikimi periodik i kurrikulës dhe bashkëpunimi me institucione të tjera ofrojnë një bazë të qëndrueshme për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Po, mbështetur në evidencat e dokumentuara, rezulton se institucioni ka hartuar një procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse të studentëve, duke përcaktuar kriteret dhe standardet e përgatitjes së tezës së diplomës. Rregullorja dhe udhëzuesi përkatës ofrojnë udhëzime të qarta mbi metodologjitë e kërkimit, integrimin e njohurive të fituara dhe standardet akademike të punimit final ^{167,168} .
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët,	Institucioni ka vendosur një procedurë të qartë për asistimin e studentëve në detyrimet përmbyllëse, duke vënë në dispozicion udhëzime dhe materiale mbështetëse. Udhëzuesi për punimin e

¹⁶⁵ Shtojca 1.3. Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2022-2027

¹⁶⁶ Shtojca 2.4. Plani Strategjik për Zhvillimin e DGL

¹⁶⁷ Shtojca 2.5. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Kulturë, Media, Editim", Pika 3 - Objektivat formuese të programit

¹⁶⁸ Shtojca 2.14. Udhëzues i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë për Punimin e Diplomës

duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	diplomës u shpërndahet si studentëve, ashtu edhe mentorëve, për të siguruar ndjekjen e standardeve akademike gjatë procesit. Për më tepër, monitorimi i praktikës institucionale kryhet sipas një grafiku të miratuar, duke garantuar mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë këtij procesi ^{169,170} .
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në programin Master i Shkencave në “Kulturë, Media dhe Editim” nuk zhvillohet provim përfundimtar, por cikli i studimeve mbyllet me mbrojtjen e tezës së diplomës. Studentët kanë të drejtën të zgjedhin temën e tyre të diplomës dhe udhëheqësin shkencor në varësi të fushës së interesit. Departamenti përcakton listën e tezave në fillim të semestrit të tretë, duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon programi. Procesi i vlerësimit të tezës përfshin miratimin nga pedagogu udhëheqës, vlerësimin nga opONENTI i temës dhe shqyrtimin nga komisioni i mbrojtjes së diplomës, i cili caktohet me vendim të departamentit dhe miratim nga dekani ¹⁷¹ .
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Në këtë rast, rezulton se udhëheqësi i punimit të diplomës ka një rol kyç në orientimin e studentëve gjatë hartimit të punimit përfundimtar. Ai harton një program pune për studentin, duke përcaktuar afate të përafërta për realizimin e tij dhe duke mbajtur seanca metodologjike për të ndihmuar studentët në aspektin metodologjik dhe strukturor të punimit të diplomës. Përmes një grafiku të konsultimeve të programuara, udhëheqësi kontrollon progresin e studentit dhe siguron që puna të përmbushë standardet e kërkuara. Para mbrojtjes, ai shqyrton dhe miraton punimin, duke e firmosur atë si të gatshëm për mbrojtje. Për më tepër, tema e diplomës vlerësohet edhe nga një pedagog opONENT i caktuar nga përgjegjësi i departamentit përkatës ¹⁷² .
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga verifikimi i dokumentacionit dhe takimi me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit, konstatuam se institucioni siguron mbështetje për studentët gjatë procesit të hartimit të punimit të diplomës përmes udhëheqësit akademik, i cili asiston në çdo hap të punës kërkimore. Udhëheqësi zhvillon seanca metodologjike, ku trajtohen çështje si përcaktimi i objektit

¹⁶⁹ Shtojca 2.14. Udhëzues i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë për Punimin e Diplomës

¹⁷⁰ Shtojca 2.13. Model Grafiku i Shpërndarjes dhe Monitorimit të Praktikës Institucionale

¹⁷¹ Shtojca 2.5. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Kulturë, Media, Editim”, Pika 13

¹⁷² Shtojca 2.14. Udhëzues i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë për punimin e diplomës. Formular i vlerësimit të temës së diplomës

	të studimit, ndërtimi i hipotezave, analiza e burimeve dhe hartimi i përfundimeve. Gjithashtu, ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo dorëzimin e punimit për mbrojtje. E gjithë kjo qasje është e detajuar në udhëzuesin për punimin e diplomës, i cili vihet në dispozicion të studentëve dhe mentorëve ¹⁷³ .
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Pas mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë nga komisioni, i cili shqyrton përmbajtjen, metodologjinë dhe origjinalitetin e punimit. Vlerësimi regjistrohet zyrtarisht në sistemin akademik dhe dokumentohet me procesverbal, duke siguruar transparencën e procesit ¹⁷⁴ .
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentët që përmbushin të gjitha detyrimet akademike pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Deri në lëshimin e diplomës, ata marrin një vërtetim të përkohshëm të firmosur nga dekani dhe rektori, i cili ka vlerë të barasvlefshme me diplomën. Suplementi i diplomës përmban informacion mbi strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, kreditet dhe mundësitë e mëtejshme akademike. Gjithashtu, studentët kanë të drejtë të kërkojnë një kopje zyrtare të syllabus-eve të programit në gjuhën shqipe dhe/ose angleze ¹⁷⁵ .
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni garanton ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përpara lëshimit, çdo diplomë dhe certifikatë regjistrohet në regjistrin shtetëror të certifikatave/diplomave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. UNIKO disponon një bazë të dhënash të plotë mbi studentët dhe përpunon të dhëna statistikore për qëllime të brendshme dhe për raportim ndaj institucioneve përkatëse. Dokumentacioni arkivohet dhe ruhet pa afat kohor dhe paraqitet sipas kërkesave individuale ose institucionale ¹⁷⁶ .
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe informacionin e mbledhur gjatë vizitës institucionale, konstatohet se institucioni ka hartuar dhe ndjek një procedurë të qartë për detyrimet përmblylëse të studentëve. Udhëzuesi për punimin e diplomës është i strukturuar dhe i shpërndahet si studentëve ashtu edhe mentorëve, duke mundësuar një proces të rregullt të mbikëqyrjes akademike. Studentët asistohen nga strukturat përgjegjëse dhe udhëheqësit e diplomave për përgatitjen e punimit përmblylës,</i>

¹⁷³ Shtojca 2.14. Udhëzues i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë për punimin e diplomës. Formular i vlerësimit të temës së diplomës, Pjesa e parë, Pika II

¹⁷⁴ Shtojca 2.14. Udhëzues i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë për punimin e diplomës

¹⁷⁵ Shtojca 1.2. Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 90, 91

¹⁷⁶ Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Neni 70, pika 6 dhe 7

	ndërsa vlerësimi i tyre realizohet nga komisione të caktuara në përputhje me rregulloret institucionale. Gjithashtu, institucioni garanton lëshimin e diplomës dhe suplementit të saj, si dhe ruajtjen e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media, editim” ka të parashikuar praktikën institucionale me një ngarkesë prej 150 orësh mësimore (6 ECTS). Kjo praktikë zhvillohet pranë institucioneve të artit, kulturës dhe medias në Qarkun e Korçës, me të cilat institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Praktika synon t’u ofrojë studentëve aftësi praktike dhe një ekspozim real ndaj tregut të punës, duke u mundësuar zgjerimin e njohurive teorike, krijimin e aftësive profesionale për kërkime të mëtejshme post-master, ndërtimin e marrëdhënieve me aktorë të fushës dhe lehtësimin e mundësive për punësim afatgjatë ¹⁷⁷ .
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë rezulton se ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme në Qarkun e Korçës për të garantuar realizimin e praktikave profesionale. Këto partneritete synojnë të ndihmojnë studentët në përvetësimin e njohurive dhe kompetencave profesionale, duke i ekspozuar ata ndaj praktikave më të mira në fushën e kulturës, medias dhe botimeve. Gjithashtu, këto institucione shërbejnë edhe si oponentë për vlerësimin e cilësisë së programit, duke ofruar feedback për përmirësimin e elementeve të tij ¹⁷⁸ .
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në	Praktika institucionale në programin Master i Shkencave në Kulturë, Media dhe Editim është e integruar si lëndë plotësuese me 6 kredite (150 orë), në përputhje me VKM Nr. 185, datë 25.03.2021. Studentët ndjekin një proces të strukturuar të

¹⁷⁷ Shtojca 2.15. Udhëzues i departamentit të gjuhës dhe letërsisë mbi praktikën mësimore/institucionale

¹⁷⁸ Shtojca 2.10. Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	praktikës, e cila zhvillohet pranë institucioneve partnere, duke siguruar lidhjen me fushën e tyre të studimit. Në përfundim të praktikës, studentët dokumentojnë eksperiencën e tyre përmes raportit përfundimtar dhe formularëve të vlerësimit nga mentori akademik dhe mbikëqyrësi në institucionin pritës. Ky proces siguron monitorim dhe vlerësim të strukturuar, duke garantuar që praktika të jetë një përvojë domethënëse dhe e vlefshme për studentët. Të gjitha procedurat dhe modalitetet e zhvillimit të praktikës janë të përcaktuara në “Udhëzuesin për Praktikën Mesimore” të hartuar nga departamenti^{179,180}.			
Konkluzione	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara, programi “Master i Shkencave” në “Kulturë, media dhe editim: përfshin një praktikë institucionale të strukturuar, e cila siguron lidhjen e studentëve me fushën profesionale përmes bashkëpunimit me institucione të artit, kulturës dhe medias. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave dhe ka hartuar një udhëzues të detajuar për zhvillimin dhe vlerësimin e tyre. Procesi i praktikës është i dokumentuar, i ekuivalentuar me kredite dhe i monitoruar nga mentori akademik dhe mbikëqyrësi në institucionin pritës, duke siguruar një vlerësim të qartë të kompetencave të fituara nga studentët. Bazuar në këto gjetje, konstatohet se standardi përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

¹⁷⁹ Shtojca 2.5. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Kulturë, Media, Editim – Plani mësimor

¹⁸⁰ Shtojca 2.15. Udhëzues i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë mbi Praktikën Mësimore/Institucionale

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																										
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Referuar dokumentacionit shoqërues të paraqitur në RVB dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, në përputhje me kërkesat bashkëkohore për sigurimin e cilësisë së moduleve mësimore ¹⁸¹ Për vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar në këtë program studimi 23 pedagogë nga të cilët 14 PAE; <table><tr><th colspan="3">Personeli i angazhuar në Programin e Studimit 2022-2023</th></tr><tr><th>Titulli/Grada</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>3</td><td>2</td></tr><tr><td>Dr./Ph.D.</td><td>10</td><td>3</td></tr><tr><td>MSc. (Ph.D. Cand.)</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>MSc.</td><td></td><td>3</td></tr><tr><td>Totali:</td><td>14</td><td>9</td></tr></table> Për vitin akademik 2023-2024 kanë janë angazhuar në këtë program studimi 23 pedagogë nga të cilët 14 PAE; <table><tr><th colspan="3">Personeli i angazhuar ne Programin e Studimit 2023-2024</th></tr><tr><th>Titulli/Grada</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>6</td><td>2</td></tr><tr><td>Dr./Ph.D.</td><td>8</td><td>3</td></tr><tr><td>MSc. (Ph.D. Cand.)</td><td></td><td>1</td></tr><tr><td>MSc.</td><td></td><td>3</td></tr><tr><td>Totali:</td><td>14</td><td>9</td></tr></table> Gjithashtu, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon këtë program studimi është në përputhje të plotë me natyrën e programit dhe me cilësitë specifike të moduleve të tij.¹⁸²	Personeli i angazhuar në Programin e Studimit 2022-2023			Titulli/Grada	PAE	PAK	Prof. Asoc.	3	2	Dr./Ph.D.	10	3	MSc. (Ph.D. Cand.)	1	1	MSc.		3	Totali:	14	9	Personeli i angazhuar ne Programin e Studimit 2023-2024			Titulli/Grada	PAE	PAK	Prof. Asoc.	6	2	Dr./Ph.D.	8	3	MSc. (Ph.D. Cand.)		1	MSc.		3	Totali:	14	9
Personeli i angazhuar në Programin e Studimit 2022-2023																																											
Titulli/Grada	PAE	PAK																																									
Prof. Asoc.	3	2																																									
Dr./Ph.D.	10	3																																									
MSc. (Ph.D. Cand.)	1	1																																									
MSc.		3																																									
Totali:	14	9																																									
Personeli i angazhuar ne Programin e Studimit 2023-2024																																											
Titulli/Grada	PAE	PAK																																									
Prof. Asoc.	6	2																																									
Dr./Ph.D.	8	3																																									
MSc. (Ph.D. Cand.)		1																																									
MSc.		3																																									
Totali:	14	9																																									

¹⁸¹ Shtojca 4. Të dhëna statistikore mbi stafin, studentët, programin e studimit

¹⁸² Shtojca 2.9. Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik pranë programit të studimit është realizuar në përputhje me kërkesat dhe kuadrit rregullator në fuqi sa i takon raportit të PAE dhe PAK. Personeli akademik ka një angazhim të përcaktuar dhe të qartë për të realizuar të gjitha detyrat e mësimdhënies dhe mbulimin e moduleve të programit, duke siguruar që ngarkesa mësimore të jetë e përputhshme me kërkesat ligjore dhe standardet e akreditimit për arsimin e lartë. Kjo përfshin edhe shpërndarjen e orëve mësimore dhe angazhimin për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e procesit të mësimdhënies. 75-76 përqind e ngarkesës mësimore mbulohet nga personeli akademik me kohë të plotë dhe rreth 23-24 përqind mbulohet nga personeli akademik me kohë të pjesshme.¹⁸³
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB-së por edhe gjatë vizitës në institucion dhe takimit me zyrat përkatëse, GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimi. Punësimi i stafit PAE është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.¹⁸⁴ Angazhimi i personelit sigurohet përmes kontratave të punësimit të përditësuara dhe mbulimit të personelit akademik me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e aplikueshme për arsimin e lartë. Kjo mundëson një angazhim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të personelit akademik në mbështetje të cilësisë dhe kontinuitetit të programit gjatë periudhës së akreditimit.¹⁸⁵
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,	Bazuar në RVB dhe dokumentacionin bashkëngjitur, procedura e rekrutimit të stafit me kohë të plotë është paraqitur në mënyrë të qartë dhe të detajuar. Njësia përgjegjëse për rekrutimin mbështetet në procedurën për rekrutim të miratuar në UNIKO, e cila përcakton në mënyrë të qartë kriteret e nevojshme për pranimin e personelit. Procedura specifikon në mënyrë të detajuar procesin e vlerësimit të kandidatëve që konkurrojnë për pozicionet e lira të punës, si dhe përcakton rregullat për formimin dhe përzgjedhjen e komisionit që do të udhëheqë procesin e konkursit për ato pozicione.¹⁸⁶

¹⁸³ Shtojca 4. Të dhëna statistikore mbi stafin, studentët, programin e studimit

¹⁸⁴ Shtojca 3.8. Procedura e rekrutimit të personelit akademik

¹⁸⁵ Shtojca 2.22. Format i kontratës individuale të punës të personelit akademik

¹⁸⁶ Procedura e rekrutimit të personelit akademik

Njoftim për vend të lirë pune - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ konstaton se Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, përkatësisht Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë, siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të duhur dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve, në përputhje me rregulloren e UNIKO. IAL-ja ka angazhuar 1 personel ndihmës akademik në dy vitet akademike që kemi në shqyrtim. ¹⁸⁷ Zyra e Burimeve Njerëzore, si pjesë e strukturës organizative të institucionit, ruan dhe arkivon të dhënat e përgjithshme të dokumentuara në dosjet e personelit. Përditësimi i këtij dokumentacioni realizohet nga specialisti i sektorit të burimeve njerëzore dhe protokoll-arkivit ¹⁸⁸
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	GVJ, pas shqyrtimit të DVV dhe vizitës në institucion, konstaton se UNIKO, me përgjegjësinë e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Kulturë, Media dhe Editim. Pas verifikimit të rastësishëm të personelit, GVJ vlerësoi se informacioni është i plotë dhe në përputhje me formatin e miratuar. Përgjegjësi i Departamentit mbledh, përditëson dhe arkivon çdo vit CV-të e anëtarëve të personelit akademik dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi ¹⁸⁹
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të	GVJ konstaton se institucioni, në kuadër të marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi dhe kompani, siguron personelin e mjaftueshëm, të duhur dhe të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës profesionale, punimit të diplomës dhe aktiviteteve të tjera specifike të programit të studimit. Angazhimi i personelit është i projektuar për të ofruar mbështetje të

¹⁸⁷ Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë

¹⁸⁸ Shtojca 1.4 Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore

¹⁸⁹ Shtojca 2.9. Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit

kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	plotë për studentët në zhvillimin e aftësive profesionale dhe kërkimore, si dhe për t'u mundësuar atyre një lidhje të ngushtë me tregun e punës dhe praktikat profesionale, në përputhje me natyrën dhe kërkesat e programit të studimit. Praktika profesionale realizohet mbështetur në marrëveshjet e nënshkruara nga UNIKO me institucione dhe biznese të Korçës dhe rajonit ¹⁹⁰			
	Bazuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018", "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, praktika institucionale, është parashikuar në rregulloren e programit si lëndë plotësuese, me 6 kredite (150 orë) ¹⁹¹			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i departamentit angazhohet në mbikëqyrjen e studentëve në ambientet pritëse, si dhe në realizimin e praktikave profesionale, sipas marrëveshjeve të lidhura institucionalisht, për të siguruar përmbushjen e detyrimit për kryerjen e praktikës profesionale. Në përfundim të praktikës profesionale, personeli mbikëqyrës në ambientin ku realizohet praktika, përgatit një relacion përfundimtar vlerësimi mbi ecurinë dhe arritjet e studentit gjatë kryerjes së praktikës profesionale. E gjithë kjo procedurë është e rregulluar nga Rregullorja e Njesisë Bazë ¹⁹²			
Konkluzione	GVJ konstaton se, institucioni i përmbush kërkesat e përcaktuara për angazhimin e personelit akademik sipas kualifikimit të përcaktuar. Zyra e Burimeve Njerëzore, si pjesë e strukturës organizative të institucionit, ruan dhe arkivon të dhënat e përgjithshme të dokumentuara në dosjet e personelit. Personeli mbikëqyr e praktikat profesionale të studentëve në bashkëpunim me institucionet bashkëpunuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

¹⁹⁰ Shtojca 2.10. Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

¹⁹¹ Shtojca 2.5. Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave në "Kulturë, Media, Editim"

¹⁹² Shtojca 2.5. Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave në "Kulturë, Media, Editim"

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ konstaton se institucioni siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, të cilat janë të organizuara në përputhje me numrin e studentëve, grupet mësimore dhe natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse ¹⁹³ <table border="1"> <thead> <tr> <th>Mjedisi</th><th>Nr. Sallash</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni + seminari</td><td>21</td></tr> <tr> <td>Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj</td><td>5</td></tr> <tr> <td>Zyra për stafin</td><td>13</td></tr> <tr> <td>Bibliotekë</td><td>2</td></tr> <tr> <td>Zyra Informacioni për Studentë</td><td>2</td></tr> </tbody> </table> Mjediset janë të strukturuar dhe të përshtatshme për nevojat e procesit të mësimdhënies dhe mbështesin zhvillimin e një mësimi cilësor dhe efektiv ¹⁹⁴	Mjedisi	Nr. Sallash	Salla leksioni + seminari	21	Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	5	Zyra për stafin	13	Bibliotekë	2	Zyra Informacioni për Studentë	2
Mjedisi	Nr. Sallash												
Salla leksioni + seminari	21												
Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	5												
Zyra për stafin	13												
Bibliotekë	2												
Zyra Informacioni për Studentë	2												
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore, përfshirë klasat, laboratorët, studio dhe mjediset e tjera të dedikuara për zhvillimin e procesit mësimor, janë të pajisura me mjete elektronike dhe teknologjinë e informacionit të nevojshme për të garantuar një realizim efikas të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këto mjedise janë të furnizuara me pajisje moderne, si kompjuterë, projektorë, sisteme të komunikimit dhe teknologji të tjera që mbështesin përdorimin e metodologjive bashkëkohore. Godina është e pajisur me linjë interneti dhe në të gjitha zyrat e personelit, klasat, laboratorët dhe auditorët, krahas rrjetit të internetit (kabllor/lan) funksionon edhe sistemi ëireless i internetit, duke i'u mundësuar studentëve akses interneti edhe në ambientet e jashtme. Në infrastrukturë përfshihet edhe një Qendër e Formimit të Vazhduar me infrastrukturë të plotësuar digjitale (kompjuter, laptop, Smart TV, Ëhite Board, videoprojektor etj) ¹⁹⁵												

¹⁹³ Shtojca 1.15. Raport i kontrollit të MAS për kapacitetet pritëse të UNIKO

¹⁹⁴ Shtojca 4. Të dhëna statistikore për stafin, studentët, programin e studimit (Tabela 16)

¹⁹⁵ Shtojca 4. Të dhëna statistikore për stafin, studentët, programin e studimit (Tabela 16)

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Gjatë vizitës në institucion, u vu re se laboratorët, studiot, atelietë dhe mjediset e tjera, janë në përputhje me natyrën e programit të studimit. Ambientet janë të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme për realizimin e kërkesave të moduleve të programit, si dhe për përmbushjen e objektivave formues teorikë dhe praktikë. Mjetet dhe pajisjet janë të avancuara dhe të adaptuara për të mbështetur zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike të studentëve, duke mundur një mësim të thelluar dhe të plotë. Këto mjedise janë të strukturuar në mënyrë që t'u mundësojnë studentëve të aplikojnë njohuritë teorike në kontekste praktike dhe reale, duke siguruar përgatitjen e tyre për sfidat e profesionit pas diplomimit.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni mundëson së paku shfrytëzimin e dy laboratorëve të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. Mjediset e personelit akademik dhe ndihmës akademik, sipas kërkesave, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, me qëllim përmbushjen e roleve përkatëse ¹⁹⁶
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë	Institucioni garanton, përmes kapaciteteve që zotëron, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione dhe subjekte të jashtme sigurojnë mundësi për studentët të zhvillojnë aftësitë praktike në mjedise që janë të përgatitura dhe të përshtatshme për programet e studimit të ofruara. Specifikisht, FEF dhe Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme publike të qarkut Korçë për të garantuar realizimin e praktikave me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale, si dhe për t'i përdorur këto institucione si partnerë të rëndësishëm dhe njëkohësisht si oponentë për të marrë feedback-un e duhur për të përmirësuar elemente të programit të studimit ¹⁹⁷.

¹⁹⁶ Shtojca 4. Të dhëna statistikore për stafin, studentët, programin e studimit (Tabela 16)

¹⁹⁷ Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Qendra Këshillimi të Karrierës dhe Alumnit, nga ana tjetër mban në informacion koherent studentët për mundësitë që ofrojnë institucione të ndryshme për intershipse ose punësime të mundshme ¹⁹⁸			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion është konstatuar se UNIKO ka në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional të procesit mësimor. Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme publike të qarkut Korçë për të garantuar realizimin e praktikave me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë vizitës së zhvilluar në Bibliotekën e institucionit, GVJ konstaton se institucioni siguron literaturën bazë dhe ndihmëse për studentët, duke garantuar kështu marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme që janë të parashikuara në programin e studimit. Literatura është e përzgjedhur dhe e organizuar në përputhje me kërkesat e moduleve të programit, duke ofruar burime të nevojshme për studime të thelluara dhe për përvetësimin e teorisë dhe praktikës në fushën e studimit¹⁹⁹. Buxheti institucional parashikon gjithashtu fonde vjetore për pasurimin e bibliotekave të fakulteteve me botime të kërkuara nga personeli akademik i çdo njësie, të cilat vihen në dispozicion të studentëve për aktivitete hulumtuese, realizimin e detyrave të kursit, projekteve lëndore dhe punimeve të diplomës²⁰⁰. Studentët mund të

¹⁹⁸ Qendra e Karrierës dhe Alumni - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

¹⁹⁹ Kopje të materialeve mbështetëse/shoqëruese të mësimdhënies gjenden kryesisht në librarinë/bibliotekën e fakultetit/Bibliotekën Shkencore

²⁰⁰ Shtojca 3.27 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave

	tërheqin materiale nga biblioteka e fakultetit, biblioteka shkencore, ose mund të shfrytëzojnë burimet online të sugjeruara nga pedagogu i lëndës. Po ashtu, falë investimit të AADF (Fondacioni Shqiptaro Amerikan për Zhvillim) në kuadër të projektit “CleanScore”, Biblioteka Shkencore ka qasje në burime të rëndësishme si JSTOR ²⁰¹
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ ka konstatuar se njësia përgjegjëse ka implementuar një proces të rregullt dhe të strukturuar për përditësimin e literaturës, duke siguruar që bibliotekat të pasurohen me botime të fundit dhe materiale të reja ²⁰² . Ky proces mundëson që studentët dhe stafi akademik të kenë akses në informacionin më të avancuar dhe më të përditësuar, i cili përputhet me kërkesat dhe zhvillimet më të reja në fushën e studimit, duke siguruar cilësinë dhe relevancën e burimeve për mësimdhënie dhe kërkime shkencore ²⁰³ . Rishikimi i syllabuseve kryhet cdo vit akademik nga personeli përgjegjës duke marrë miratim edhe nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe asaj Kryesore. ²⁰⁴
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ ka konstatuar se institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke siguruar mundësinë e shfrytëzimit të saj në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit. Biblioteka është e hapur dhe e aksesueshme për studentët në çdo kohë, duke mundësuar përdorimin e materialeve shkencore dhe edukative në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë ata që janë pjesë e programit të studimit, pa ndonjë diskriminim ose kufizim. Biblioteka disponon një literaturë specifike për programin e studimit Master i Shkencave në “Kulturë, Media, Editim”, e cila përmban 2827 njësi si literaturë shkencore, 304 fjalorë të tipologjive të ndryshme dhe 10728 njësi libra artistikë në gjuhën shqipe, të cilat jepen për shfrytëzim brenda mjediseve të bibliotekës dhe jashtë saj, brenda një afati kohor të paktën 2 javor.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën	Gjatë vizitë në institucion, u vu re se biblioteka është e pajisur me një fond të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm të literaturës, duke përfshirë tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, si dhe libra dhe revista shkencore të nevojshme për mbulimin e të gjitha moduleve dhe veprimtarive mësimore të programit të studimit. Ky fond është

²⁰¹ JSTOR Home

²⁰² Shtojca 3.27 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave

²⁰³ Kopje të materialeve mbështetëse/shoqëruese të mësimdhënies gjenden kryesisht në librarinë/bibliotekën e fakultetit/Bibliotekën Shkencore

²⁰⁴ Shtojca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit

shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	i pasur me materiale në gjuhën shqipe dhe të huaja, të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe hulumtues, dhe janë të përshtatshme për specifikat dhe kërkesat e programit të studimit. Kjo mundëson që studentët të kenë akses në burime të pasura dhe të ndryshme, duke mbështetur kështu kërkesat e larta akademike dhe nevojat për mësimdhënie cilësore ²⁰⁵ .
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni ka krijuar kushte të përshtatshme për shfrytëzimin e barabartë dhe pa pagesë të bibliotekave online për studentët e programit të studimit. Këto bibliotekat online ofrojnë akses në një gamë të gjerë materialesh dhe burimesh akademike të fushës përkatëse, duke mundësuar që studentët të kenë qasje në literaturën më të re dhe më të avancuar në çdo kohë dhe pa asnjë kosto shtesë ²⁰⁶ . Kjo mundësi garanton që të gjithë studentët, pavarësisht kushteve socio-ekonomike, të kenë mundësi të barabartë për zhvillimin e kërkimeve të tyre akademike dhe përmbushjen e detyrave të studimit ²⁰⁷ .
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se, biblioteka digjitale e UNIKO (U-LIBRARY) ofron akses të plotë në gjashtë (6) baza të të dhënave të botimeve shkencore, ku personeli akademik dhe studentët mund të regjistrohen përmes një llogarie të vetme dhe fjalëkalimi. Për më tepër, stafi akademik dhe studentët kanë gjithashtu akses në një fond librash të dhuruara nga Instituti Gëte, si dhe një Smart-Board të vendosur në mjediset e bibliotekës së fakultetit, që mundëson përdorimin e teknologjisë për mbështetje të mësimdhënies. Biblioteka shkencore e UNIKO dhe biblioteka e Fakultetit janë të pajisura me salla studimi dhe kompjuterë që kanë lidhje me internet, duke mundësuar kështu mundësi për punë individuale dhe në grupe. Kompjuterët janë të instaluar me programe bazë kompjuterike që përdoren nga studentët për realizimin e detyrave sipas specifikave të moduleve të lëndëve ²⁰⁸ .
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të	Biblioteka është e hapur për studentët në orare shërbimi që janë të përshtatshme me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, për t'iu

²⁰⁵ JSTOR Home

²⁰⁶ EBSCO | Access Scholarly Content on EBSCOhost

²⁰⁷ Shtojca 3.27 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave

²⁰⁸ Shtojca 4. Të dhëna statistikore për stafin, studentët, programin e studimit (Tabela 16)

studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	përgjigjur nevojave të studentëve dhe kapacitetit të bibliotekës. Specifikisht, Biblioteka e FEF është në shërbim të përdoruesve nga dita e hënë deri ditën e premte, nga ora 8.00 deri në orën 16.00, oraret e saj janë publike dhe funksionon përmes kartelave të regjistrimit. Ky disponueshmëri e shërbimit siguron që studentët të kenë mundësinë të shfrytëzojnë bibliotekën për studime, kërkime, apo për realizimin e detyrave dhe projekteve akademike.			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se stafi i punonjësve të bibliotekës është përgjegjës për raportimin e informacionit që ka të bëjë me përditësimin e fondit fizik dhe fondit on-line të bibliotekës përkatëse. Ky proces siguron që fondet e bibliotekës të mbeten të përditësuara dhe të përshtatshme për nevojat e studentëve dhe stafit akademik, duke garantuar mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin e aktiviteteve mësimore dhe kërkimore. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë rregullisht cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës, duke përfshirë titujt kryesorë që janë në shërbim të programit të studimit.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka siguruar kushte të përshtatshme për ofrimin e burimeve të nevojshme për mbështetje të procesit mësimor dhe kërkimor. Biblioteka është e pajisur me fonde të mjaftueshme, si në format fizik ashtu dhe online, që plotësojnë kërkesat e programit të studimit dhe ofrojnë mundësi të barabarta për shfrytëzim nga studentët. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë rregullisht cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës, duke përfshirë titujt kryesorë që janë në shërbim të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nok përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në bazë të dokumentacionit të ofruar dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se sekretaria mësimore e UNIKO-s është përgjegjëse për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët, duke mbuluar proceset që fillojnë nga regjistrimi dhe vazhdojnë deri në diplomim. Gjatë takimit në sekretarinë e programit, u shqyrtuan regjistrat e studentëve dhe një dosje të zgjedhur nga programi i studimit e cila përmbante informacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi i përdorur për menaxhimin e të dhënave është platforma PITAGORA, një sistem i informatizuar që administron të dhënat e studentëve nga momenti i regjistrimit në universitet deri në diplomimin e tyre²⁰⁹. PITAGORA mundëson efikasitet në administrimin e të dhënave nga ana e stafit akademik dhe ofron mundësinë e marrjes së informacionit në kohë reale nga ana e studentëve²¹⁰.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ ka vlerësuar se sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit, PITAGORA, është efikas dhe administron informacionin dhe dokumentacionin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe studentëve. Mundëson gjithashtu akses të shpejtë dhe të sigurt në informacion për të gjithë personelin dhe përmirëson efikasitetin në koordinimin e aktiviteteve të ndryshme akademike. Ky sistem siguron që të dhënat të jenë të përditësuara dhe të menaxhuara në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë ²¹¹ .
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma PITAGORA mundëson një administrim efikas të të dhënave nga ana e stafit akademik, si dhe mundësinë për marrjen e informacionit në kohë reale nga studentët. Sistemi ka përmirësuar shërbimet e sekretarisë, duke lehtësuar proceset e hedhjes dhe ruajtjes së të dhënave, dhe gjithashtu mundëson paraqitjen në rrjet të informacionit të lidhur me grafikun e provimeve, rezultatet, kreditet, kurrikulën dhe programet lëndore.

²⁰⁹ Shtojca 1.6 Manuali i sistemit elektronik PITAGORA

²¹⁰ Shtojca 1.6.1 Marrëveshja me RASH për sistemin PITAGORA

²¹¹ Shtojca 1.6 Manuali i sistemit elektronik PITAGORA

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Platforma PITAGORA është një sistem menaxhimi i cili mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna të lidhura me stafin dhe studentët e UNIKO-s. GVJ ka konstatuar, si nga analiza e RVB-së ashtu edhe nga vizita në institucion, se ky sistem elektronik konsiderohet një mjet interaktiv dhe efikas për komunikimin e vazhdueshëm me studentët²¹². Përveç kësaj, UNIKO publikon informacion në faqen e saj zyrtare, ëëë.unkorce.edu.al, e cila përditësohet rregullisht. Programi i Transparencës, i instaluar në këtë faqe, ofron një gamë të gjerë informacioni, duke përfshirë kornizën ligjore të veprimtarisë së stafit akademik dhe administrativ, të dhënat mbi studentët, si dhe marrëdhëniet me publikun, palët e interesit dhe personat juridikë²¹³.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ ka konstatuar se sistemi i menaxhimit Pitagora, i implementuar në UNIKO garanton një monitorim të detajuar dhe në kohë reale të aktiviteteve akademike dhe administrative. Ky sistem mundëson që të dhënat të përpunohen dhe të jenë të disponueshme për organet dhe autoritetet drejtuese, duke ofruar raporte individuale dhe statistika të përditësuara në kohë reale. Kjo mundësi siguron që të gjitha aktivitetet akademike dhe administrative të monitorohen dhe menaxhohen në mënyrë efikase, duke garantuar transparencë dhe mundësi për ndërhyrje të shpejta në rast nevojë. Përmes këtij sistemi, UNIKO mund të sigurojë një administrim të saktë dhe të standardizuar të të dhënave, duke mundësuar një pasqyrë të plotë të ecurisë së programeve dhe aktiviteteve përkatëse.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UNIKO disponon një faqe zyrtare Eëb, e cila, përveç informacionit të përgjithshëm në nivel universitar, ofron gjithashtu të dhëna të përditësuara për secilin fakultet dhe departament²¹⁴. Secili seksion përkatës në këtë faqe pasqyron informacion mbi programet e studimit, stafin akademik, veprimtaritë akademike dhe aktivitetet kërkimore shkencore. Për programin e studimit “Master i Shkencave në Kulturë, Media, Editim”, informacioni i detajuar, përfshirë të dhënat mbi personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme, është i disponueshëm në nënfaqen e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë. Ky informacion përfshin objektivat e programit, organigramën, stafin akademik, departamentet, programet e studimit, infrastrukturën, veprimtaritë e ndryshme,

²¹² Shtojca 1.6 Manuali i sistemit elektronik PITAGORA

²¹³ <https://unkorce.edu.al/programi-i-transparences/>

²¹⁴ Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë | Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

	botimet, leksionet dhe njoftimet përkatëse ²¹⁵ . <i>Gjithsesi, GVJ vuri re që informacionet janë vetëm në gjuhën shqipe dhe rekomandon që të punohet për të shfaqur informacionin edhe në gjuhën angleze.</i>			
Konkluzione	UNIKO përdor një sistem të avancuar për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre në universitet duke garantuar monitorimin e aktiviteteve akademike dhe administrative në kohë reale, duke mundur menaxhim efikas dhe transparent. Të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, stafin akademik, apo aktivitetet, janë të disponueshme dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit të UNIKO në gjuhën shqipe. GVJ rekomandon që informacioni të jetë edhe në gjuhën angleze në faqen ëeb.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga takimi i zhvilluar në institucion dhe evidencat e depozituara nga UNIKO, konstatojmë se Njësia bazë funksionon në përbërje të njësisë kryesore, pa pasuar buxhet të individualizuar në kuptimin e njësisë shpenzuese ²¹⁶ . Institucioni siguron një mbështetje të qëndrueshme financiare për zhvillimin e programit të studimit përmes një kombinimi burimesh financiare. Krahas fondeve që alokohen nga buxheti i shtetit në formën e transfertës së pakushtëzuar, të ardhurat kryesore për mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike dhe kërkimit shkencor gjenerohen nga tarifat e studentëve ²¹⁷ . Gjithashtu, institucionet sigurojnë të ardhura dytësore përmes shërbimeve të kryera dhe marrëdhënieve me palët e treta. Ndërkaq, të ardhurat shtesë mund të sigurohen nga donacionet dhe pjesëmarrja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat kontribuojnë në forcimin e financimeve dhe mbështetjen e iniciativave kërkimore dhe zhvillimore të programit.

²¹⁵ UNIKO - PROGRAMET E STUDIMIT

²¹⁶ Shtojca 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave e UNIKO

²¹⁷ Shtojca 2.23. Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO

	Buxheti financiar hartohet çdo vit nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Financës në drejtimin e administratorit të UNIKO ²¹⁸²¹⁹ .
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV se hartimi i planit të financimit, bazohet në strukturën buxhetore që përdoret për hartimin e buxhetit të shtetit, sipas zërave kryesorë buxhetorë: Shpenzime nga grandit buxhetor, si dhe Shpenzimet nga të ardhurat e veta. Në vijim plani i financimit detajohet në mënyrë më analitike me gjithë elementët e shpenzimeve që parashikon për mbulimin e shpenzimeve operative, burimeve njerëzore, investimet për logjistikën dhe pajisjet. Në të përcaktohen edhe përparësitë që do të ketë në investimet e tre viteve të ardhshme në përputhje të plotë me nevojat infrastrukturore dhe logjistike ²²⁰ .
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Universiteti i Korçës (UNIKO) i nënshtrohet një auditimi të rregullt nga tri nivele kryesore të kontrollit. Auditimi i brendshëm financiar realizohet nga strukturat e kontrollit të brendshëm të institucionit, ndërsa auditimi i jashtëm zhvillohet çdo dy vjet nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu, UNIKO i nënshtrohet auditimit të jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Për më tepër, institucioni siguron transparencë për publikun duke bërë të njohur pasqyrën e të ardhurave që gjenerohen nga tarifat e studentëve dhe burime të tjera financiare. Raporti financiar, i përgatitur nga administratori i universitetit, përfshin të gjithë elementët e nevojshëm në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për pasqyrat financiare. Ky raport diskutohet në analizën vjetore dhe, së bashku me

²¹⁸ Shtojca 1.7 Rregullore e Drejtorisë Ekonomike

²¹⁹ Shtojca 1.8 Rregullore e Drejtorisë së Financës

²²⁰ Shtojca 2.23. Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO

	dokumentacionin shoqërues, i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) ²²¹ .			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në informacionin e DVV, në fund të çdo viti, UNIKO raporton rezultatet e auditimit në takimet e hapura, të cilat organizohen në formën e analizave vjetore të punës. Këto takime kanë një pjesëmarrje të gjerë nga asambleja akademike dhe studentët, duke siguruar transparencë dhe përfshirje të të gjithë grupeve të interesit ²²² .			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, burimet financiare të UNIKO përfshijnë: buxhetin e shtetit, tarifat e studentëve për arsimim, të ardhurat nga shërbimet e ofruara, të ardhurat nga marrëdhëniet me palët e treta, donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi, si dhe të ardhurat nga veprimtaritë kërkimore shkencore ²²³ . Kur ka kërkesa nga njësitë bazë për financim shtesë ose përmirësimin e situatës financiare, dhe me miratimin e organeve drejtuese të UNIKO, mund të realizohen ndërhyrje të veçanta në buxhetin e shpenzimeve ose në regjistrin e prokurimeve, për të mbuluar ndryshimet eventuale në financimin e programeve të studimit, me qëllim të siguruarit të vazhdimësisë dhe cilësisë së veprimtarisë akademike dhe kërkimit shkencor ²²⁴ .			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se, UNIKO harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Institucioni i nënshtrohet një kontrolli dhe auditimi të brendshëm dhe të jashtëm. Si institucion buxhetor, UNIKO siguron qëndrueshmërinë financiare të nevojshme për zhvillimin e programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²²¹ Shtojca 2.23. Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO

²²² PROGRAMI I TRANSPARENCES - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

²²³ Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë

²²⁴ Shtojca 2.23. Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, Statutin dhe Rregulloret e UNIKO-s, si dhe informacionin e disponueshëm në faqen zyrtare të internetit të institucionit, GVJ arrin në përfundimin se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. Rregulloret e UNIKO-s ²²⁵ dhe të Fakultetit ²²⁶ përcaktojnë hapat që ndiqen për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ konstaton se këto akte janë në përputhje me legjislacionin aktual. Procesi i regjistrimit zhvillohet në përputhje me udhëzimet e përcaktuara dhe studentët e pranuar pajisen me numër matrikullimi.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në Statutin e tij, UNIKO zbaton politika të mundësive të barabarta për të gjitha programet e studimit. Institucioni i jep rëndësi diversitetit dhe siguron mundësi të barabarta për pranimin e studentëve pavarësisht racës, fesë, origjinës etnike ose statusi personal. Institucioni ka ngritur Këshillin e Etikës në nivel universiteti për të siguruar respektimin e të drejtave të studentëve dhe stafit. ²²⁷
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Institucioni harton dhe publikon përpara fillimit të çdo viti akademik kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve për pranim në programet e studimit. Aktet rregullatore, si statuti dhe rregulloret e brendshme, ofrojnë një kuadër të qartë për procesin e pranimin të studentëve. ²²⁸ Nëpërmjet hartimit të kriterëve të pranimin në përputhje me ligjin dhe vendimet e Senatit, UNIKO siguron një proces të drejtë dhe të barabartë për studentët e tyre, duke përmirësuar kështu përvojën e tyre akademike.

²²⁵ Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO

²²⁶ Rregullore FEF

²²⁷ Kodi i etikës së universitetit Fan S. Noli

²²⁸ Shtojca 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë (DGJL)

Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Institucioni ka kritere të përcaktuara për pranimin e studentëve në programet e studimit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.²²⁹ Transferimi i studentëve në programin e studimit bëhet në përputhje me procedurat e transferimit të studentëve të UNIKO dhe Ligjin për Arsimin e Lartë. Gjatë takimit me zyrën e informacionit për studentët dhe takimit me studentët, u konfirmua që studentëve kandidat i paraqiten verbalisht të gjitha kriteret dhe informatat e rëndësishme që duhet të dinë lidhur me procesin e aplikimit dhe transferimit.²³⁰
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UNIKO informon publikun për programet e studimit në faqen zyrtare të ëebit (https://unkorce.edu.al/), e cila azhurnohet rregullisht për të ofruar informacion të detajuar në lidhje me institucionin, strukturën e tij akademike dhe programet e studimit. Faqja e ëebit pasurohet me veprimtari akademike, sociale, kulturore dhe studentore. Universiteti menaxhon edhe forma informimi më të gjerë si Guida e Universitetit, broshura promociionale për programet e studimit dhe kriteret e pranimit, lajmërimi në media.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi se UNIKO ka hartuar kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj. Institucioni parashikon kuota të dedikuara për kandidatë me aftësi të veçanta, nga pakica dhe shtresa të marginalizuara.²³¹
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit zyrtar, konstatohet se institucioni harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera përpara fillimit të çdo viti akademik.²³² Dokumentet përkatëse, duke përfshirë rregulloret institucionale dhe udhëzimet e brendshme, përcaktojnë në mënyrë të qartë procedurat dhe kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët ndërkombëtarë për pranim në programet e studimit. Në kuadrin rregullator të UNIKO parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit edhe të studentëve shqiptarë etnikë jashtë kufijve, si edhe nga çdo shtetas i huaj, por që plotësojnë kriteret e parashikuara të pranimit në programin e

²²⁹ Shtojca 3.26 Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve

²³⁰ Shtojca 2.5 Rregullorja e programit të studimit: Master i Shkencave në "Kulturë, medi dhe editim"

²³¹ Shtojca 1.26. Udhëzim nr. 12 "Për regjistrimin e studentëve"

²³² Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë

	studimit dhe në respektim të Udhëzimeve të MAS. ²³³			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Bazuar në VKM Nr. 903, dt 21.12.2016, konstatohet se institucioni, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, njofton dhe ofron bursa apo përfitime financiare për studentët ekselentë dhe ata që ndjekin programe studimore të konsideruara si prioritare në nivel kombëtar. Dokumentet rregullatore dhe aktet institucionale përcaktojnë kriteret dhe procedurat për dhënien e këtyre bursave, duke siguruar transparencë dhe mundësi të barabarta për aplikantët e kualifikuar.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se, në kuadrin rregullator të UNIKO parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimi të studentëve në programet të gjitha programet e studimit, si dhe procedurat lidhur me ecurinë e tyre deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në ose nga programe të tjera. UNIKO ka hartuar kuotat e pranimi për kategori të veçanta si për kandidatët nga trojet, pakicat kombëtare etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në dokumentacionit e paraqitur në RVB, si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe të publikuar në faqen zyrtare të UNIKO, GVJ konstaton se institucioni siguron akses të plotë për studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik si dhe me procesin e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Rregulloret e Fakultetit dhe programit të studimit ²³⁴ përcaktojnë qartë të gjitha aspektet e përparimit akademik dhe transferimit të krediteve, duke garantuar transparencë dhe lehtësimin e procesit për studentët. Për më tepër, përdorimi i sistemit të automatizuar Pitagora mundëson akses në kohë reale për studentët mbi vlerësimet akademike, programet e lëndëve dhe të gjithë ciklin e

²³³ Rregullore FEF

²³⁴ Shtojca 2.5 Rregullorja e programit të studimit: Master i Shkencave në "Kulturë, medi dhe editim"

	studimeve, duke rritur efektivitetin e menaxhimit të të dhënave akademike.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe gjetjet nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO, përmes sekretarisë mësimore dhe në bazë të rregullores së Fakultetit ²³⁵ , informon dhe orienton studentët mbi mundësinë e njohjes së krediteve dhe kualifikimeve të mëparshme. Kriteret dhe procedurat për njohjen e krediteve, si dhe transferimi i studimeve, përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë përgjegjëse për transferimet ²³⁶ , duke siguruar përputhshmëri me legjislacionin në fuqi. Për më tepër, studentët mund të marrin informacione të detajuara pranë Zyrës së Informimit të Studentëve, sekretarisë mësimore të departamentit. ²³⁷
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Vlerësimi i studentëve në programin “Master i Shkencave në Kulturë, Media dhe Editim” mbështetet në Rregulloren e UNIKO dhe atë të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (FEF), duke garantuar transparencë dhe qartësi në procesin akademik. ²³⁸ Metodat e vlerësimit përfshijnë testime me shkrim dhe me gojë, ese, detyra kursi, projekte, praktika, prezantime dhe tezën e diplomës, të cilat përcaktohen në syllabuset e lëndëve dhe komunikohen me studentët në fillim të çdo semestri. Sistemi i vlerësimit ndahet në: • Vlerësim të vazhduar (30%), i cili përfshin angazhimin gjatë semestrit. • Vlerësim përfundimtar (70%), që siguron analizën gjithëpërfshirëse të arritjeve akademike. Studentët kanë akses të vazhdueshëm në informacion mbi progresin dhe rezultatet e tyre akademike përmes sistemit PITAGORA, i cili shërben si platformë kryesore për publikimin e notave dhe detajeve mbi procesin e vlerësimit ²³⁹ . Për më tepër, pedagogët komunikojnë drejtpërdrejt me studentët në fund të procesit mësimor mbi të drejtën për t’u futur në provime dhe rezultatet e vlerësimit të vazhdueshëm.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në	Institucioni, përmes sekretarisë mësimore dhe koordinatorit të programit të studimit, siguron transparencë dhe akses të plotë në

²³⁵ Rregullore FEF

²³⁶ Shtojca 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë (DGJL)

²³⁷ Shtojca 2.2 Rregullorja e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF

²³⁸ Rregullore FEF

²³⁹ Shtojca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA

lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	kriteret dhe procedurat e diplomimit. Informacioni është i disponueshëm përmes rregulloreve dhe udhëzimeve të publikuara në platformën zyrtare të UNIKO dhe në sistemin e menaxhimit PITAGORA. Rregullorja e programit të studimit ²⁴⁰ dhe Udhëzuesi për Punimin e Diplomës ²⁴¹ përcaktojnë qartë të gjitha hapat e procesit, duke përfshirë përzgjedhjen e temës, mentorimin nga pedagogu udhëheqës, afatet kohore dhe kriteret e dorëzimit.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Koordinator i programit ka një rol kyç në sigurimin e aksesit dhe shpërndarjes së informacionit mbi programin “Master i Shkencave në Kulturë, Media dhe Editim” për të gjitha kategoritë e kandidatëve. Ky proces realizohet përmes strategjive të promovimit, të cilat përfshijnë: • Takime informuese me maturantët dhe studentët e viteve të fundit të programeve bachelor në fusha të ngjashme, si Gjuhë dhe Letërsi, duke theksuar përfitimet dhe perspektivat profesionale të programit.²⁴² • Aktivitete promovuese të organizuara në bashkëpunim me shkolla të mesme dhe fakultete të tjera, duke rritur ndërgjegjësimin dhe interesin e kandidatëve për këtë program studimi.²⁴³ UNIKO organizon gjithashtu fushata promovuese me studentë të viteve të fundit bachelor si dhe harton broshura informative gjatë prezantimeve të realizuara.			
Konkluzione	GVJ konstaton se, UNIKO siguron akses të plotë për studentët mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik përmes platformës PITAGORA, si dhe mbi procesin e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Gjithashtu, studentët disponojnë informacion të detajuar mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi dhe procedurat e diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

²⁴⁰ Shtojca 2.5 Rregullorja e programit të studimit: Master i Shkencave në “Kulturë, medi dhe editim”

²⁴¹ Shtojca 2.14. Udhëzues i departamentit të gjuhës dhe letërsisë për punimin e diplomës

²⁴² Shtojca 3.11. Praktika e promovimit dhe informimit të maturantëve

²⁴³ Shtojca 3.12. Praktika e informimit të studentëve me programin e studimi

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Informimi i studentëve bëhet përmes Rregullores së Fakultetit²⁴⁴, broshurave, materialeve të përgatitura për këtë qëllim dhe platformës zyrtare të universitetit. Procesi i informimit fillon në javën e parë të vitit akademik dhe vazhdon përmes takimeve informuese të organizuara nga departamenti dhe Qendra për Këshillim dhe Karrierë. Studentët informohen për strukturën e programit dhe mundësitë që ofrohen nëpërmjet syllabuseve të detajuara të lëndëve dhe materialeve të tjera informuese, të cilat janë të aksesueshme edhe përmes monitorëve dhe stendave në fakultet. Për informacione shtesë, ata mund të drejtohen në Qendrën e Informimit të Studentëve dhe sekretarinë e departamentit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentëve u ofrohet të gjithë informacioni i nevojshëm, përfshirë syllabuset, që në javën e parë të studimeve. Ky informacion është i disponueshëm si online, ashtu edhe në version të printuar në guidën e studentit, e cila u dorëzohet studentëve që në fillim të vitit akademik. Përveç kësaj, studentët kanë mundësinë të takohen me pedagogët dhe të marrin informacione shtesë mbi programin. Ata informohen gjithashtu për akreditimin e programeve dhe institucionit, si dhe vlefshmërinë e diplomës, nëpërmjet koordinators të programit. Për më tepër, studentët kanë akses në informacionin e plotë mbi lëndët dhe modulet që duhet të ndjekin gjatë vitit akademik përmes llogarive të tyre në sistemin elektronik PITAGORA. Ky sistem ofron detaje të plota mbi kurrikulën e programit, kreditet, semestrin kur zhvillohet çdo lëndë dhe informacion të tjera të rëndësishme.²⁴⁵
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	UNIKO ka ngritur në strukturën e tij edhe Qendrën për Këshillim dhe Karrierë (QKA) ALUMNI. Misioni i Qendrës është të ofrojë shërbime cilësore për studentët, të diplomuarit dhe stafin, me qëllim përmirësimin e cilësisë së edukimit dhe zhvillimin e potencialit të tyre, për t'u përgatitur për tregun e punës pas përfundimit të studimeve.²⁴⁶ Pjesë e kësaj është edhe shërbimi i mentorimit, i cili mbështet studentët gjatë periudhave kritike të

²⁴⁴ Rregullore FEF

²⁴⁵ Shtojca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA

²⁴⁶ Shtojca 1.5. Rregullorja e drejtorisë së kurrikulës dhe vlerësimit institucional

	jetës akademike, duke ofruar mundësi këshillimi si dhe praktika profesionale. Në takimet e para me studentët e programit, koordinatorët ofrojnë informacion të detajuar mbi mundësitë e zhvillimit profesional dhe mundësitë e punësimit pas përfundimit të programit.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Një përshkrim i plotë i ambienteve të logjistikës ofrohet që në fillim të programit, dhe gjatë vizitave të organizuara në institucion, studentët dhe kandidatët marrin informacion mbi shërbimet për studentët, programin e studimit, logjistikën institucionale dhe aspekte të tjera të rëndësishme. Informacionet më të rëndësishme janë gjithashtu të disponueshme në faqen zyrtare të institucionit dhe në stendat e departamentit.²⁴⁷ Për më tepër, siç u theksua gjatë takimeve me Stafin Akademik të Programit, këto informacione ofrohen edhe gjatë ditëve të hapura të organizuara në fillim të çdo viti akademik nga të gjitha strukturat e IAL që mbështesin studentët, si dhe nga koordinorët e programit, të cilët prezantojnë çdo lëndë gjatë javës së parë të studimeve.²⁴⁸			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Për të gjithë studentët që regjistrohen në UNIKO, u sigurohet një emër përdorimi dhe kod personal, me qëllim mundësimin e aksesit të sistemit të brendshëm të menaxhimit. Studentët marrin informacion në kohë reale përsa i përket listës së tyre të notave, mungesat e kryera, si edhe situatën e tyre financiare. Kjo procedurë kryhet në sistemin e menaxhimit online dhe aksesit i mundësohet në çdo ambient nga ku mund të ketë lidhje me internet.²⁴⁹			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se, struktura dhe organizimi i programit janë publike dhe mund të aksesohen nga studenti si online ashtu edhe nëpërmjet broshurave apo edhe komunikimit me koordinatorin e programit. Organizimi i takimeve, ditëve të hapura dhe ofrimi i informacionit përmes kanaleve të ndryshme garanton një integritet të suksesshëm të studentëve në program dhe krijimin e mundësive për zhvillimin e tyre profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²⁴⁷ udherefyesi2022.pdf

²⁴⁸ Shtojca 2.11.2. Vendimi i njësisë bazë për emërimin e koordinorëve të programeve të studimit

²⁴⁹ Shtojca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mësimore mban të dhëna të plota për regjistrimin, transferimet dhe diplomimet e studentëve. Informacionet mbi studentët dhe të diplomuarit ruhen në databazën elektronike të sistemit Pitagora, si dhe në regjistrat fizikë, duke mundësuar akses të lehtë dhe raportim të detajuar mbi ecurinë akademike. Statistikave për numrin e studentëve të diplomuar i'u jepet rëndësi e veçantë, për të cilën QKA harton një raport të plotë mbi ecurinë e studentëve të diplomuar në këtë program si dhe fushën e tyre të punësimit ²⁵⁰ . Po ashtu, ato përfshijnë të dhëna mbi punësimin e studentëve pas diplomimit, të cilat janë një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e ndikimit të programit në tregun e punës. ²⁵¹
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Bazuar në Rregulloren e UNIKO, sekretaria mësimore ka përgjegjësinë për menaxhimin e të gjitha proceseve që lidhen me regjistrimin, organizimin, monitorimin dhe arkivimin e dokumentacionit dhe të dhënave për studentët. ²⁵² Ky rol siguron që informacionet mbi studentët të ruhen në mënyrë të strukturuar dhe të përditësuar, duke mundësuar një menaxhim efikas të proceseve administrative dhe akademike. Ky përditësim ndihmon Sekretarinë Mësimore që të ofrojë të dhëna të sakta që nevojiten si për zbatimin e legjislacionit në fuqi ashtu edhe raporteve apo studimeve të kryera nga vetë institucioni. ²⁵³
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht	Të dhënat mbi regjistrimin dhe ecurinë akademike të studentëve ruhen në format të shkruar dhe elektronik, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale ²⁵⁴ . Sektori i Studimeve dhe TIK ²⁵⁵ menaxhon sistemin PITAGORA, ku studentët mund të regjistrohen dhe të ndjekin ecurinë e tyre akademike, përfshirë rezultatet e provimeve. Ky informacion është

²⁵⁰ Shtojca 3.24. Analiza vjetore Qendra e Karrierës dhe Alumni

²⁵¹ Shtojca 3.25. Të dhëna mbi gjurmimin/punësimin e studentëve që kanë përfunduar programin

²⁵² Shtojca 1.10. Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK

²⁵³ Shtojca 1.2. Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO

²⁵⁴ Shtojca 1.9. Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale

²⁵⁵ Shtojca 1.10. Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK

të verifikueshme nga personat e autorizuar.	i disponueshëm në mënyrë individuale dhe konfidenciale për studentët.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ vlerësoi se UNIKO kryen kontroll periodik të të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët dhe veprimtaritë e tyre në nivel fakulteti dhe universiteti. Sektori i kurrikulës, vlerësimit institucional dhe Alumni është i përfshirë në matjen e performancës dhe hartimin e planeve për përmirësime. Manuali i Cilësisë përshkruan detajet e veprimtarisë së këtij sektori dhe planifikimin kalendarik. Ai koordinon punën e NJSBC në fakultete dhe sekretaritë mësimore, duke raportuar drejtpërdrejt autoriteteve të universitetit për masat që duhet të ndërmerren. ²⁵⁶			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Sipas informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit në DVV, njësia Kryesore ²⁵⁷ dhe ajo bazë ²⁵⁸ , harton dhe analizon periodikisht raporte analitike mbi ecurinë e veprimtarisë akademike dhe mësimore. Në këto raporte, përfshihen aspekte që lidhen me cilësinë, hyrjen dhe daljen e studentëve, si dhe sfidat dhe mundësitë e punësimit të tyre. Njësia bazë përdor këtë informacion për të realizuar analizat e saj periodike. Një raport specifik mbi fushën e punësimit të studentëve përpilohet edhe nga QKA. ²⁵⁹			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UNIKO harton raporte që përmbajnë statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar dhe transferuar. Sistemi i brendshëm i informacionit mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe siguron ruajtjen e tyre në përputhje me standardet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

²⁵⁶ Shtojca 1.16, Manuali i Cilësisë, UNIKO, Studentët dhe Sigurimi i Cilësisë

²⁵⁷ Shtojca 2.20. Analiza vjetore e veprimtarisë së FEF

²⁵⁸ Shtojca 2.21. Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë (DGJL

²⁵⁹ Shtojca 3.24. Analiza vjetore Qendra e Karrierës dhe Alumni

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UNIKO ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, në përputhje me aktet ligjore dhe rregullat e brendshme të institucionit²⁶⁰. Këshillat Studentore në nivel fakulteti janë organizata të pavarura, përfaqësuesit e të cilave zgjidhen nga vetë studentët dhe përfaqësojnë interesat e tyre me një mandat 2-vjeçar.²⁶¹ Ky angazhim siguron që studentët të kenë mundësi të kontribuojnë në proceset vendimmarrëse dhe të ndikojnë në politikat dhe praktikatat akademike të institucionit. Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës si dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UNIKO parashikon në aktet rregullatore të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në vendimmarrje si në Senatin Akademik, Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë, si edhe Këshillin e Etikës. Një student është gjithashtu pjesë e grupit të punës për hartimin e raportit të Vlerësimit të Brendshëm gjatë procesit të akreditimit për hartimin e RVB. ²⁶²
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në	Duke pasur përfaqësues të studentëve në Senatin Akademik dhe Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, organeve përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të programeve, studentët janë të përfshirë në procesin e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve akademike ²⁶³ . Ky angazhim realizohet gjithashtu edhe në një masë më të gjerë duke përfshirë të gjithë studentët drejtpërdrejtë përmes pyetësorëve që zhvillohen nga NJSBC për vlerësimin e lëndëve dhe pedagogëve ²⁶⁴ . Kështu, studentët japin kontribut të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së programit. ²⁶⁵

²⁶⁰ Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"

²⁶¹ Shtojca 1.18. Rregullorja për organizimin e zgjedhjeve

²⁶² Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"

²⁶³ Shtojca 1.17. Rregullorja e këshillit studentor

²⁶⁴ Shtojca 3.7. Raportet vjetore të NJSBC

²⁶⁵ Shtojca 1.16, Manuali i Cilësisë, UNIKO, Studentët dhe Sigurimi i Cilësisë

departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.				
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në Sipas rregullores të Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore ²⁶⁶ , Studenti ka të drejtën të ankimojë notën e provimit brenda ditës së marrjes së rezultatit, duke e paraqitur ankimin me shkrim tek Dekani i Fakultetit. Ky i fundit shqyrton ankesën dhe mbledh të gjitha të dhënat përkatëse lidhur me kërkesën e studentit, duke e paraqitur atë pranë pedagogut të lëndës për rishikim të vlerësimit, nëse është e arsyeshme.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se, UNIKO parashikon dhe angazhon studentët në vendimmarrje, të cilat kontribuojnë në hartimin, miratimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj studentëve. Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës si dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Njësia Kryesore dhe ajo Bazë në bashkëpunim të vazhdueshëm me Zyrën e Informimit, Këshillimit të Karrierës, si edhe personeli akademik, ofrojnë informacionin e plotë të nevojshëm për studentët, si edhe mbajnë kontakte të vazhdueshme me ta, për të siguruar një shërbim sa më të mirë ndaj tyre ²⁶⁷ . Kjo kryhet edhe nepërmjet publikimit të informacionit në faqen zyrtare Eeb, Platformat online apo broshurave dhe fletëpalosjeve. GVJ konstatoi se UNIKO me përdorimin e sistemit të menaxhimit të brendshëm “Pitagora” mundëson komunikimin e stafit akademik dhe studentëve si dhe ndjekjen e ecursisë akademike në kohë reale.

²⁶⁶ Shtojca 2.2. Rregullorja e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF

²⁶⁷ Shtojca 2.2. Rregullorja e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FE

Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni ka krijuar një sistem të strukturuar dhe funksional për informimin, këshillimin dhe mbështetje në ndjekjen e përparimit të studentëve. Zyra e informimit dhe orientimit të studentëve ofron asistencë për studentët e rinj dhe ato aktualë, duke u ofruar informacione mbi programet e studimit, kërkesat akademike dhe pyetjet që ata mund të kenë. Po ashtu, sekretaria mësimore, stafi akademik dhe autoritetet drejtuese ofrojnë mbështetje dhe këshilla gjatë gjithë ciklit të studimeve. Pjesë e këtij sistemi është edhe Qendra për Këshillim dhe Karrierë në UNIKO, e cila ofron mbështetje për studentët gjatë dhe pas përfundimit të studimeve, duke ofruar këshillim dhe informacion të nevojshëm për orientimin profesional dhe mundësitë e karrierës. Ndjekja e përparimit të studentëve në lidhje me procesin mësimor ndiqet lehtësisht edhe nga sistemi i menaxhimit të brendshëm.²⁶⁸
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Institucioni ofron shërbimin e këshillimit të karrierës për studentët përmes Zyrës për Këshillimin e Karrierës, e cila është në dispozicion të studentëve në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike²⁶⁹. Kjo zyrë ofron informacion dhe orientim në lidhje me mundësitë për praktika profesionale në institucione me të cilat UNIKO ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe orienton studentët në tregun e punës²⁷⁰. QKA-ja shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë.²⁷¹
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të	Në databazën të Zyrës së Karrierës dhe Alumni mbahen statistika dhe hartohen raporte vjetore ku përfshihen të gjithë studentët e diplomuar në të gjitha programet e studimit²⁷², si edhe identifikohet fusha e punësimit për këta studentë duke e integruar në analizën vjetore që përmban informacion dhe të dhëna mbi statusin e punësimit si dhe institucionet ku janë punësuar²⁷³.

²⁶⁸ Shtojca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA

²⁶⁹ Shtojca 3.6 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit

²⁷⁰ Shtojca 2.13 Tabela përmbledhëse programi i praktikës profesionale/ mësimore/ institucionale

²⁷¹ QKA - STATISTIKA - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

²⁷² Tabela përmbledhëse

²⁷³ Shtojca 3.24 Analiza vjetore qendra e karrierës e alumit

programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Kontaktet me industrinë dhe institucionet mbahen nga kjo Zyrë përmes lidhjeve të vazhdueshme me Alumni, si dhe me kontakte të rregullta me institucione publike dhe kompani ku janë punësuar ish-studentët.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se, UNIKO ka ngritur njësi të cilat janë në dispozicion të informimit dhe shërbimit të studentëve. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet nga Qendra e Këshillimit të Karrierës, e cila harton edhe raporte mbi punësimin e të diplomuarve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në takimet me stafin dhe studentët e UNIKO, GVJ konstatoi se Institucioni ka struktura dhe procedura të mirëpërcaktuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me strategjinë institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. Në aktet rregullatore të UNIKO si Statuti, Rregullorja e Fakultetit, e Departamentit si dhe në rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar qartë procesi i mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit përfshirë edhe integrimin e teknologjive të avancuara, rishikimin e programeve mësimore për t'iu përgjigjur nevojave të tregut është edhe pjesë e strategjisë së institucionit ²⁷⁴ . Ky program studimi është i organizuar në përdorimin e metodave të mësimdhënies, që ndërthurin leksionet, seminarët, praktikat laboratorike, diskutimet në klasë, orët e mësimimit me në qendër

²⁷⁴ Shtojca 2.2. Rregullorja e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF

	studentin, duke integruar në çdo rast përdorimin e teknologjisë së informacionit. ²⁷⁵ UNIKO ka përkushtim ndaj metodologjive të reja të mësimdhënies dhe ka marrë pjesë në trajnime të organizuara për metodat bashkëkohore të mësimdhënies. ²⁷⁶
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Treguesit kryesorë të performancës maten përmes hartimit të raportit të vetëvlerësimit, monitorimit të vazhdueshëm të dokumentacionit, si dhe përmes rritjes së ndërgjegjësimit të rolit të stafit dhe studentëve në sigurimin e cilësisë, nëpërmjet përdorimit të anketave dhe pyetësorëve. Këto procese mundësojnë përcaktimin e rekomandimeve për përmirësim dhe monitorimin e vazhdueshëm të masave të ndërmarra. Vlerësimi i stafit akademik në lidhje me cilësinë e mësimdhënies realizohet përmes pyetësorit të përgjithshëm, i cili zhvillohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në bashkëpunim me Këshillin Studentor.²⁷⁷ Performanca e stafit akademik vlerësohet në bazë të arritjeve të tij në fushën akademike dhe kërkimore, duke u mbështetur në analizat që realizohen pas përfundimit të secilit modul, si dhe nëpërmjet analizave vjetore të departamentit, sipas modelit të miratuar në manualin e cilësisë.²⁷⁸
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	UNIKO inkurajon aktivisht përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe ofrimin e sugjerimeve nga ana e studentëve, duke e konsideruar këtë si një mjet të rëndësishëm për arritjen e objektivave të mësimdhënies. Pyetësorët e shpërndarë jo vetëm që ndihmojnë në përmirësimin e metodologjive mësimore, por gjithashtu nxjerrin në pah shqetësimet dhe pakënaqësitë e studentëve. Mënyra për shprehjen e këtyre shqetësimeve ose sugjerimeve është e mundur përmes procesit të ankimimit pranë Dekanit të Studentëve.²⁷⁹ Studentët janë gjithashtu të angazhuar në komisionet për sigurimin e cilësisë, dhe përfaqësohen në Senatin Akademik, si dhe në Këshillin e Etikës dhe Bordin e Administratës. Studentët kanë të drejtë të ankohen për vlerësimin e dijës dhe metodologjinë e ndjekur, në përputhje me Rregulloren për Procedurat e Ankimimit, e cila përcakton hapat dhe mënyrën e trajtimit të këtyre ankesave, duke siguruar transparencë dhe drejtësi në procesin e vlerësimit akademik.²⁸⁰

²⁷⁵ Tabelat përmbledheëse (Tab. 10)

²⁷⁶ LMS - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

²⁷⁷ Shtojca 3.14. Pyetësi studentor

²⁷⁸ Shtojca 3.5. Shembull i vlerësimit të performancës të stafit të rekrutuar rishtaz

²⁷⁹ Shtojca 3.7. Raportet vjetore të NJSBC

²⁸⁰ Shtojca 2.3. Rregullorja e njësisë bazë (DGJL)

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Gjatë takimeve të zhvilluara me njësitë përgjegjëse, GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve të pedagogeve nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, janë diskutuar në mbledhjet e Dekanateve ose në departamente, me qëllim nxitjen e diskutimit mbi nevojën për përmirësimin e kurrikulës, metodave të mësimdhënies dhe infrastrukturës në të cilën ajo zhvillohet. Në përfundim të çdo viti, rezultatet e auditimit prezantohen në takimet e hapura, të cilat organizohen në formën e analizave vjetore të punës, ku merr pjesë një audiencë e gjerë, përfshirë anëtarët e asamblesë akademike dhe studentët. ²⁸¹ Raportet dhe rezultatet e vlerësimit publikohen gjithashtu në faqen zyrtare të UNIKO, duke garantuar transparencë dhe akses të plotë për të gjithë të interesuarit. Kjo praktikë siguron informim të vazhdueshëm dhe ndihmon në krijimin e një mjedisi të hapur dhe të përgjegjshëm për gjithë komunitetin akademik dhe publik.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Përgjatë analizës bazuar në informacionin nga RVB dhe DVV, si dhe nga vizita me stafin dhe përfaqësuesit e NJSBC, GVJ ka vlerësuar se raportet e vlerësimeve të personelit janë diskutuar në mbledhjet e dekanateve dhe departamenteve, duke pasur si qëllim nxjerrjen e diskutimeve konstruktive që promovojnë praktikën e mira dhe inkurajojnë përmirësimin e mëtejshëm të stafit akademik. UNIKO mbështet stafin akademik për të realizuar studime si brenda ashtu dhe jashtë vendit, përmes mundësisë së vitit sabatik, dhe e inkurajon atë të marrë pjesë në tryeza të rumbullakëta diskutimesh dhe trajnime, të cilat janë pjesë e kornizës zbatuese të projekteve ndërkombëtare ku universiteti është i angazhuar ²⁸² . Për më tepër, UNIKO promovon stafin akademik përmes organizimit të veprimtarive që mundësojnë prezantimin e kontributit akademik dhe shoqëror të kërkimit shkencor të stafit për një publik më të gjerë. ²⁸³			
Konkluzione	GVJ shprehet se, Institucioni ka krijuar struktura të qarta për të garantuar dhe promovuar cilësinë e mësimdhënies, duke përdorur metodologji dhe mjetet e nevojshme për monitorimin dhe përmirësimin e performancës së stafit. UNIKO inkurajon aktivisht përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²⁸¹ Shtojca 3.7. Raportet vjetore të NJSBC

²⁸² Shtojca 1.21 Rregullore për rregullat dhe standardet e përfitimit të së drejtës për vitin akademik sabatik

²⁸³ Shtojca 2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare të UNIKO

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni ka krijuar struktura të përshtatshme për sigurimin e cilësisë, si dhe procedura të zhvilluara për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin aktual dhe në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë. Kjo është e përcaktuar edhe në Statutin e Universitetit, ku roli i strukturës themelore, siç është NJSBC, dhe nën-strukturave mbështetëse, si Sektori i Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, është i qartë²⁸⁴. Të gjitha këto struktura kanë si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve, me fokus në rritjen e cilësisë akademike, mësimdhënien dhe shërbimet si objektiva strategjike.²⁸⁵ Për të mbështetur implementimin e këtyre procedurave, njësitë përgjegjëse kanë hartuar rregulloren përkatëse, Manualin e Sigurimit të Cilësisë²⁸⁶ dhe Rregulloren për Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional²⁸⁷. Kontrolli i cilësisë dhe përgatitja e raporteve përkatëse bëhet çdo vit dhe ka si qëllim realizimin e objektivave strategjike të IAL për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.²⁸⁸ <i>Por, nga ana tjetër, nga analiza e dokumentacionit dhe nga vizita në institucion u vërejt se praktikat e administrimit të dokumentacionit nuk janë plotësisht të unifikuara. Përdorimi i formateve të ndryshme dhe burimeve të shpërndara mund të kufizojë koordinimin dhe të ndikojë në efikasitetin e analizës së të dhënave.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO ka krijuar struktura të brendshme, procese dhe udhëzime për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe ka një njësi të dedikuar që merret me menaxhimin e cilësisë së programeve të studimit dhe koordinimin e proceseve për

²⁸⁴ Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"

²⁸⁵ Shtojca 2.2. Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FEF

²⁸⁶ Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO

²⁸⁷ Shtojca 1.5. Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional

²⁸⁸ Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit UNIKO

institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	përmirësimin e vazhdueshëm. Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni është aktivisht i angazhuar në matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e planeve për përmirësime të mundshme. Aktivitetet e tij janë të përshkruara në Manualin e Cilësisë të UNIKO dhe detajohen në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. ²⁸⁹
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Sistemi i sigurimit të cilësisë përfshin një sërë mekanizmesh, ku përfshihen planet vjetore, analizat e pyetësorëve dhe anketimeve, si dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të jashtme.²⁹⁰ Manuali i Cilësisë është dokumenti kyç për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), duke siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe hartohet mbi një sërë mekanizmesh, përfshirë pyetësorët për lëndët, mësimdhënien dhe tematika të tjera që fokusohen në përmirësimin e cilësisë.²⁹¹ Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të akreditimit, ndërsa Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë është dokumenti kryesor që rregullon këtë proces.²⁹² Për të plotësuar rekomandimet e dhëna gjatë procesit të akreditimit, NJSBC harton një plan dhe monitoron zbatimin e vazhdueshëm të këtyre rekomandimeve.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë krijojnë analiza dhe raporte të vazhdueshme, duke përfshirë vlerësimin e pedagogëve, të cilat realizohen përmes hartimit të Raportit Vjetor të Vlerësimit të Brendshëm. Ky raport përfshin arritjet e realizuara dhe vlerëson nevojat për përmirësimin e punës. ²⁹³ Për rritjen e cilësisë, çdo anëtar i stafit akademik, përveç mësimdhënies, është i angazhuar gjithashtu në kërkimin shkencor, pjesëmarrjen në grupe pune akademike dhe projekte mobiliteti, si Erasmus+, veçanërisht për pedagogët e rinj, për të financuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore dhe akademike. ²⁹⁴
Konkluzione	<i>Institucioni ka zhvilluar dhe implementuar politika dhe procedura të qarta për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, duke integruar metoda të ndryshme monitorimi si anketat e studentëve,</i>

²⁸⁹ Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO

²⁹⁰ Shtojca 2.21. Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë

²⁹¹ Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO

²⁹² Shtojca 3.7.1 Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm UNIKO

²⁹³ Shtojca 2.21. Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë

²⁹⁴ Shtojca 2.19 Mobilitete staf ERASMUS +

	vlerësimin e pedagogëve dhe sondazhe për punëdhënësit. Rezultatet e këtyre aktiviteteve përpunohen në raporte të detajuara, të cilat përdoren për të identifikuar arritjet dhe dobësitë dhe për të hartuar masa për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	UNIKO përdor procese formale dhe të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit të ciklit të dytë, përfshirë programin "Master i Shkencave në Kulturë, Media, Editim". Këto mekanizma përfshijnë vlerësime të realizuara nga NJSBC në bashkëpunim me grupet e vlerësimit të brendshëm (GVB), të cilat analizojnë strukturën kurrikulare, rezultatet e të nxënit, dhe përfshirjen e praktikave të mira, duke identifikuar gjithashtu dobësitë ²⁹⁵ . Procesi vlerësues gjithashtu merr parasysh mendimet e studentëve dhe ish-studentëve përmes pyetësorëve dhe anketave. Rezultatet e vlerësimeve përfshihen në Raportet e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilat përmbajnë plane masash dhe rekomandime për autoritetet vendimmarrëse si Dekanati dhe Rektorati ²⁹⁶ . Raportet bëhen publike përmes kanaleve zyrtare, duke përfshirë faqen e internetit dhe standat informuese të FEF. Ky proces promovon praktikën më të mira dhe siguron përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit ²⁹⁷ .

²⁹⁵ Shtojca 3.7. Raporti vjetor i NJSBC

²⁹⁶ Shtojca 2.21. Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë

²⁹⁷ Shtojca 2.20. Analiza vjetore e veprimtarisë së FEF

Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet e analizës vjetore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe punës kërkimore shkencore në nivel njësie bazë²⁹⁸, njësie kryesore dhe IAL përfshijnë vlerësimin e performancës së stafit dhe aktivitetëve të mësimdhënies dhe kërkimit, duke analizuar arritjet dhe problematikat e identifikuar. Ato ofrojnë një analizë të shkaqeve të mangësive dhe përmbajnë masa konkrete për përmirësim. Raportet gjithashtu përfshijnë motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, duke nënvizuar sukseset e personelit akademik dhe studentëve, si dhe përparimin në fushat e mësimin dhe kërkimit shkencor. Për të siguruar përmirësimin e cilësisë në të ardhmen, në raport përfshihet një seksion i parashikimit të aktivitetëve mësimore dhe kërkimore për vitin akademik pasues, duke përcaktuar qëllimet dhe masat për rritjen e performancës.²⁹⁹
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Institucioni përdor një gamë mekanizmesh për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe programeve të studimit, përfshirë vlerësimet nga studentët, kolegët, alumni dhe partnerët, të cilat synojnë identifikimin e aspekteve që kërkojnë përmirësim dhe evidentimin e pikave të forta që mund të shpërndahen për përmirësimin e punës së stafit. Për këtë qëllim, përdoren metoda të drejtpërdrejta si pyetësorët e studentëve dhe vlerësimi i përparimit të tyre, si dhe tërthorta si vlerësimi/vetëvlerësimi i stafit akademik.³⁰⁰ Një tjetër mekanizëm i rëndësishëm për rritjen e cilësisë është organizimi i seminareve akademike, rishikimi i syllabuseve duke marrë parasysh mendimet e studentëve dhe monitorimi i vazhdueshëm i programeve mësimore. Ky proces bëhet transparent dhe i drejtpërdrejtë, duke siguruar një vlerësim të drejtë dhe gjithëpërfshirës³⁰¹. Për të mbështetur këtë proces, integrimi i cilësisë së mësimdhënies me politikat mbështetëse për studentët krijon mundësinë për disa struktura mbështetëse, si Koordinator i Programit dhe Zyra e Karrierës, të cilat ndihmojnë në arritjen e këtij objekti.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të	Institucioni ka krijuar një proces të strukturuar dhe të dokumentuar për sigurimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit "Master i Shkencave në Kulturë, Media, Editim", duke përdorur instrumente

²⁹⁸ Shtojca 2.21. Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë

²⁹⁹ Shtojca 2.23. Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore & Financiare e UNIKO

³⁰⁰ Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët

³⁰¹ Shtojca 3.7. Raporti vjetor i NJSBC

studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	të ndryshme vlerësimi si pyetësorë për punëdhënësit, sondazhe për studentët dhe gjurmimin e alumnëve. Ky proces mbështetet në Manualin e Cilësisë të UNIKO, që siguron përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare³⁰². Formulari i Vlerësimit të Performancës së Stafit Akademik mbulon aspekte kyçe si metodologjia e mësimdhënies, përdorimi i teknologjisë dhe lidhja e teorisë me praktikën³⁰³. Analiza e këtyre rezultateve dhe planifikimi i masave për përmirësim janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë së programit dhe arsimit të ofruar.³⁰⁴			
Konkluzione	<i>Institucioni realizon monitorimin dhe vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit përmes NjSBC dhe strukturave të tjera, duke përfshirë pjesëmarrjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Ky proces ka për qëllim sigurimin e arritjes së objektivave të programit dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të studentëve, për t'i përgatitur ata sa më mirë për kërkesat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të	Institucioni siguron përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit përmes strukturave dhe procedurave të qarta, të cilat janë në përputhje me Kodin e Cilësisë të Republikës së Shqipërisë dhe me objektivat e “Planit Strategjik të Zhvillimit të

³⁰² htojca 1.16. Manuali i Cilësisë UNIKO

³⁰³ Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët

³⁰⁴ Shtojca 3.7. Raporti vjetor i NjSBC

jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Universitetit ³⁰⁵ . IAL përpiqet të rrisë cilësinë e mësimdhënies duke integruar nevojat e tregut të punës dhe duke zhvilluar kurrikula që i përgjigjen këtyre kërkesave. NJSBC dhe mekanizma të tjerë të angazhuar në procesin e sigurimit të cilësisë mbështeten nga ekspertë të jashtëm dhe ligjorë për të siguruar një angazhim të efektshëm të burimeve njerëzore dhe për të respektuar procedurat e përcaktuara në Manualin e Cilësisë ³⁰⁶ .
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në Statutin e UNIKO përcaktohen qartë struktura organizative, të drejtat dhe detyrimet e njësive, individëve, studentëve dhe palëve të tjera të angazhuara në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. ³⁰⁷ Statuti thekson rëndësinë e organizimit të sigurimit të cilësisë përmes Shtojca 1.5. Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional ³⁰⁸ në nivel IAL-je dhe Njesisë së Sigurimit të Cilësisë në çdo njësi kryesore të UNIKO. Aktivitetet e këtyre strukturave përfshijnë kontrollin periodik të kurrikulave dhe syllabuseve, organizimin e orëve leksionesh të hapura me pjesëmarrje të lektorëve të jashtëm, dhe nxitjen e përmirësimit të treguesve të performancës dhe cilësisë së programeve të studimit. Këto aktivitete garantojnë një sistem të qartë përgjegjësish dhe detyrash për të gjitha palët e angazhuara, duke siguruar ushtrimin e detyrave me përgjegjësi për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. ³⁰⁹
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit, përfshihen në mënyrë aktive njësitë bazë dhe kryesore, personeli akademik, ndihmës-akademik, administrativ dhe studentët ³¹⁰³¹¹ . Kjo përfshirje dokumentohet përmes raporteve të përgatitura nga NJSBC ³¹² dhe analizave vjetore, si dhe përpunimit të të dhënave të mbledhura nga anketimet. Të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës-akademik kontribuojnë me diskutime, opinione dhe sugjerime në lidhje me përfundimet dhe rekomandimet e pasqyruara në raportet e analizave vjetore, të cilat diskutohen dhe miratohen në takimet e organizuara nga Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë, apo edhe në nivelin e njësisë kryesore. Për më tepër, studentët janë pjesë e këtij procesi vlerësimi,

³⁰⁵ Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit UNIKO

³⁰⁶ Shtojca 1.16. Manuali i Cilësisë UNIKO

³⁰⁷ Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë

³⁰⁸ Shtojca 1.5. Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional

³⁰⁹ Shtojca 3.7. Raporti vjetor i NJSBC

³¹⁰ Shtojca 2.21. Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë

³¹¹ Shtojca 2.20. Analiza vjetore e veprimtarisë së FEF

³¹² Shtojca 3.7. Raporti vjetor i NJSBC

	duke plotësuar pyetësorë ³¹³ dhe duke marrë pjesë në takimet që organizon njësia bazë kur është e nevojshme.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Karakteristikat kryesore të anëtarëve të NJSBC përfshijnë integritetin, pavarësinë, objektivitetin, profesionalizmin dhe aftësinë për të komunikuar dhe informuar. Këta anëtarë zgjidhen nga Senati Akademik dhe përfaqësojnë të gjitha fakultetet dhe këshillin studentor, duke garantuar një proces të sigurt dhe të drejtë për sigurimin e cilësisë në përputhje me kuadrin ligjor, siç është përcaktuar në statutin e universitetit ³¹⁴ . Për të siguruar ndershmëri dhe shmangur çdo formë diskriminimi apo pabarazie, IAL ka hartuar Kodin e Etikës, i cili është në përputhje me legjislacionin përkatës ³¹⁵ . Anëtarët e këtyre organeve janë të zgjedhur nga stafi akademik, duke siguruar se ata janë individë me eksperiencë dhe integritet, për të garantuar një trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë studentët dhe pedagogët.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë janë gjithashtu ekspertët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, të cilët mund të jenë akademikë, drejtues institucionesh, ose liderë biznesesh. Ky grup aktorësh, duke pasur njohuri dhe interes të drejtpërdrejtë në programin e studimit, kontribuojnë me ekspertizën dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e cilësisë së programit. Po ashtu, bashkëpunimi me institucione homologe ³¹⁶ brenda dhe jashtë vendit me të cilat UNIKO ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, si dhe ekspertë të fushës, ka qenë një faktor kyç në shkëmbimin e përvojave dhe vlerësimeve që ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit, duke ndjekur edhe Planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit 2022-2027 ³¹⁷ .			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se, Institucioni përdor mjete të ndryshme për monitorimin e cilësisë, duke përfshirë njësitë akademike, personelin akademik, studentët, si dhe partnerët institucional dhe alumni. Përmes aktiviteteve të tilla si leksione të hapura me biznese private dhe ekspertë të fushës, si dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, UNIKO angazhon bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm në vlerësimin e cilësisë së programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

³¹³ Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët

³¹⁴ Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"

³¹⁵ Shtojca 1.19 Kodi i Etikës së Universitetit FAN S. NOLI

³¹⁶ Shtojca 3.6 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit

³¹⁷ Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit UNIKO

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit janë të dokumentuara në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Statutin dhe Rregulloren e Institucionit, si dhe në Planin Strategjik. Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti ofrojnë një sërë dokumentash që janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme për të gjithë palët e interesuara. Këto dokumenta përfshijnë aktet ligjore, rregulloret dhe manualët e cilësisë, të cilat mund të merren në mënyrë të drejtpërdrejtë nga faqja zyrtare e internetit të institucionit, duke siguruar transparencë dhe akses të lehtë për studentët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit akademik. ³¹⁸³¹⁹
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Vlerësimet e studentëve për pedagogët përpunohen nga NJSBC dhe shpërndahen në mënyrë elektronike tek departamenti dhe fakulteti. Pas përfundimit të vlerësimit, komentet dhe konkluzionet u ndahen pedagogëve përkatës, duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave. ³²⁰
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimeve të kryera për programin pasqyrohen në Raportin Vjetor të Fakultetit dhe Departamentit dhe shoqërohen me një plan veprimi. Ky plan përfshin nevojat për përmirësimet akademike dhe aktivitetet që synojnë përmirësimin dhe zhvillimin e cilësisë akademike. Rekomandimet e nxjerra janë orientuese dhe të fokusuara në realizimin e misionit dhe vizionit të programit. ³²¹
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e	Raportet vjetore, të përgatitura nga strukturat përkatëse, pasqyrojnë aktivitetet e ndërmarra për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve mësimore. Raporti Vjetor i NJSBC ofron një pasqyrë

³¹⁸ Shtojca 1.2 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO

³¹⁹ <https://unkorce.edu.al/>

³²⁰ Shtojca 2.23. Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO

³²¹ Shtojca 2.20. Analiza vjetore e veprimtarisë së FEF

veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	të plotë të realizimit të objektivave dhe të progresit të programeve të studimit, duke kontribuar në identifikimin e dobësive dhe përcaktimin e masave për përmirësimin e cilësisë, të cilat shërbejnë si bazë për vendimmarrjen dhe zhvillimin e mëtejshëm ³²² .			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin akademik dhe studentët për t'i informuar dhe ndërgjegjësuat ata mbi rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë së programit të studimit. Këto aktivitete përfshijnë takime, diskutime dhe prezantime që janë të fokusuara në vlerësimin dhe zhvillimin e programeve të studimit, duke siguruar një komunikim të hapur dhe të vazhdueshëm mes të gjithë aktorëve të përfshirë ³²³ . Përmes këtyre veprimtarive, gjithashtu përfshihen analiza dhe sugjerime mbi përmirësimin e programeve, të cilat janë të integruara në proceset e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, duke siguruar një angazhim të plotë të studentëve dhe stafit akademik në përpjekjet për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se, politikat, proceset dhe aktivitetet e realizuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë të publikuara dhe transparente, duke siguruar një implementim efektiv të tyre. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin akademik dhe studentët për t'i informuar dhe ndërgjegjësuat ata mbi rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

³²² Shtojca 3.7. Raporti vjetor i NJSBC

³²³ Shtojca 2.21. Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Kulturë, Media dhe Editim” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Pikat e forta dhe afirmime

1. Institucioni ka angazhuar në programin e studimit një personel akademik me një eksperiencë të pasur dhe një karrierë akademike të spikatur në fushën përkatëse të studimit.
2. Institucioni ka ndërtuar partneritete të suksesshme me institucione publike dhe private brenda vendit, duke mundësuar mundësi zhvillimi praktike dhe punësimi për studentët pas përfundimit të studimeve.
3. Pjesëmarrja e personelit akademik në mobilitetet Erasmus+ ka pasur një ndikim pozitiv të dukshëm, duke kontribuar në përmirësimin e aftësive të tyre si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkimin shkencor.
4. Institucioni demonstroi një shkallë të lartë punësimi të studentëve pas diplomimit, veçanërisht në fusha që lidhen drejtpërdrejt me programin e studimit. Kjo dëshmon për përputhjen e mirë midis formimit akademik dhe kërkesave të tregut të punës.

Pika të dobta

1. Angazhim i kufizuar i studentëve, alumni dhe aktorëve të jashtëm në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.
2. Zbatimi i pabarabartë i praktikave të reja pedagogjike u vu re në disa raste.

Rekomandime

1. Rekomandohet që analiza e tregut të punës, në momentin e dytë që do të ribëhet, të zgjerohet përtej kontekstit rajonal, duke përfshirë të dhëna dhe tendenca në nivel kombëtar. Kjo do të mundësonte një përafrim më të plotë të objektivave të programeve të studimit me kërkesat reale të tregut të punës në shkallë vendi, duke reflektuar profilin e gjerë gjeografik të studentëve të institucionit.
2. Rekomandohet që syllabuset e lëndëve të harmonizohen me aktet rregullatore në fuqi dhe të unifikohen në një format të standardizuar në nivel institucioni. Kjo do të siguronte koherencë në strukturën dhe përmbajtjen e tyre, si dhe përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe akademike të sistemit të arsimit të lartë.
3. Rekomandohet angazhimi më domethënës dhe shtuar i studentëve, alumni dhe aktorëve të jashtëm në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.
4. GVJ sugjeron IAL që të unifikojë formatet e raportimit me qëllim rritjen e efikasitetit në analizat e të dhënave.
5. Rekomandohet të zhvillohet një sistem i përqendruar elektronik për arkivimin dhe shpërndarjen e dokumenteve që lidhen me proceset e sigurimit të cilësisë, në mënyrë që aksesueshmëria dhe transparenca e informacionit të përmirësohet për të gjithë aktorët përkatës.

6. Rekomandohet të intensifikohen iniciativat për trajnimin e stafit akademik në metodologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe vlerësimit, duke nxitur një zbatim të gjerë dhe koherent të praktikave që lidhin teorinë me praktikën dhe kërkimin shkencor.
7. GVJ sugjeron që institucioni të marrë masat që informacioni në faqen Ëeb të jetë edhe në gjuhën angleze.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Culture, Media and Editing" provided by the Higher Education Institution "Fan S. Noli University of Korçë"

Strengths and affirmations


1. The institution has engaged in the study program an academic staff with a rich experience and a distinguished academic career in the relevant field of study.
2. The institution has built successful partnerships with public and private institutions within the country, enabling practical development and employment opportunities for students after completing their studies.
3. The participation of academic staff in Erasmus+ mobilities has had a significant positive impact, contributing to the improvement of their skills in both teaching and scientific research.
4. The institution demonstrates a high employment rate of students after graduation, especially in fields directly related to the study program. This testifies to the good match between academic training and labor market requirements.

Weaknesses


1. Limited engagement of students, alumni and external stakeholders in improving the quality of the study program.
2. Uneven implementation of new pedagogical practices was observed in some cases.

Recommendation

1. It is recommended that the labor market analysis, in the second phase to be repeated, be expanded beyond the regional context, including data and trends at the national level. This would enable a more complete alignment of the objectives of the study programs with the real demands of the labor market at the national level, reflecting the broad geographical profile of the institution's students.
2. It is recommended that the course syllabi be harmonized with the regulatory acts in force and unified in a standardized format at the institution level. This would ensure coherence in their structure and content, as well as full compliance with the legal and academic requirements of the higher education system.
3. It is recommended that students, alumni and external stakeholders engage more significantly and more in improving the quality of the study program.



4. GVJ suggests that HEIs unify reporting formats in order to increase efficiency in data analysis.
5. It is recommended to develop a centralized electronic system for archiving and distributing documents related to quality assurance processes, so that the accessibility and transparency of information is improved for all relevant stakeholders.
6. It is recommended to intensify initiatives for training academic staff in contemporary teaching and assessment methodologies, promoting a broad and coherent implementation of practices that link theory with practice and scientific research.
7. The GVJ suggests that the institution take measures to ensure that the information on the website is also in English.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X